



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 10.5.2022, ora 12:30

**Drejton mbledhjen:**

**Petro Koçi – zëvendëskryetar i Komisionit**

**Flutura Aça – Kryetare e Komisionit**

**Rendi i ditës:**

- Miratimi i procesverbalit të datës 19 prill 2022.
- Seancë dëgjimore për diskutimin e raportit për veprimtarinë 1-vjeçare për vitin 2021 të Autoritetit të Medieve Audiovizive.

**Marrin pjesë:**

Flutura Aça, Petro Koçi, Besion Ajazi, Eduard Ndreca, Teuta Ramaj, Ilir Topi, Lindita Buxheli, Blerina Gjylameti, Florenc Spaho, Dasantila Tahiraj, Enslemvera Zake, Meri Markiçi, Luçiano Boçi, Agron Gjekmarkaj, Ina Zhupa, Eralda Bano, Andia Ulliri, Merita Bakiu dhe Kastriot Piroli.

**Të ftuar:**

Armela Krasniqi – Kryetare e AMA-s,  
Sara Xhumbari – drejtore e Drejtorisë Juridike dhe Licencave,  
Arben Muka – drejtor i Programeve,  
Monika Plasa - drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme.

## HAPET MBLEDHJA

**Petro Koçi** – Përshëndetje, të nderuar kolegë!

Fillojmë mbledhjen e radhës, sipas kalendarit, të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Sot në rendin e ditës kemi miratimin e procesverbalit të datës 19 prill 2022, si dhe seancën dëgjimore për diskutimin e Raportit për veprimtarinë 1-vjeçare të Autoritetit të Medieve Audiovizive.

Të ftuar nga AMA kemi kryetaren e AMA-s, zonjën Armela Krasniqi.

Mirë se erdhe, zonja kryetare!

Po ashtu kemi zonjën Sara Xhumbari, drejtore e Drejtorisë Juridike dhe e Licencave, zotin Arben Muka, drejtor i Programeve, dhe zonjën Monika Plasa, drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme.

Mirë se erdhët!

Së pari, fillojmë me miratimin e procesverbalit të datës 19 prill 2022. A ka ndonjë vërejtje? Nuk ka.

Kush është dakord me procesverbalin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet procesverbali.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës, seancë dëgjimore për diskutimin e Raportit për veprimtarinë 1-vjeçare të AMA-s.

Së pari, po ia jap fjalën kryetares së Autoritetit që të bëjë në komision një prezantim të kësaj veprimtarie 1-vjeçare.

Fjala për ju, zonja Krasniqi.

**Armela Krasniqi** – I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Në përmbushje të detyrave dhe funksioneve të AMA-s, të përcaktuara në ligjin nr. 97/2013, i ndryshuar, në planin e veprimit të Autoritetit për vitet 2021-2023, si dhe në përmbushje të rekomandimeve të Bashkimit Europian dhe të Kuvendit të Shqipërisë gjatë vitit 2021, Autoriteti është angazhuar maksimalisht t'i shërbejë shoqërisë shqiptare përmes rregullimit, mbështetjes dhe nxitjes së tregut audio dhe audioviziv të përgjegjshëm dhe cilësor.

Në vitin 2021 Autoriteti, pavarësisht gjendjes së përmirësuar, ka vijuar monitorimin për zbatimin e masave dhe protokolleve të Ministrisë së Shëndetësisë për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19 në radhët e personelit të medias, i cili angazhohet

brenda mjediseve të redaksive, të studiove të regjistrimit dhe të transmetimit, si dhe në respektimin e kufizimeve për pjesëmarrjen e publikut në programet audiovizive të drejtpërdrejta ose të regjistruara.

Vlen për t'u theksuar se të gjitha OSHMA-të, pra televizionet dhe radiot, kanë treguar gatishmëri në transmetimin pa pagesë të njoftimeve nga autoriteti shëndetësor, si pjesë e fushatës së informimit dhe ndërgjegjësimit të publikut në kushte të pazakonta, duke ndikuar drejtpërdrejt në përballimin e pasojave nga COVID-19.

Redaksitë e OSHMA-ve gjatë periudhës raportuese janë angazhuar, përmes reporterëve, redaktorëve dhe moderatorëve, për të informuar pa ndërprerje për situatën epidemiologjike në vendin tonë, por edhe duke trajtuar dhe analizuar aspekte të ndryshme, që lidheshin me aktualitetin dhe sfidat në përballjen me pandeminë. AMA ka mbajtur një qasje proaktive, duke komunikuar rast pas rasti me operatorët në lidhje me respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 97/2013, i ndryshuar, për rastet e raportimeve, bisedave, debateve në studio dhe emisioneve të ndryshme për sa i përket përcjelljes së mesazheve, që i shërbejnë informimit të saktë dhe shterues për situatën, duke shmangur panikun e popullatës.

Në procesin e monitorimit të përmbajtjeve audiovizive të transmetuara gjatë vitit 2021, AMA është fokusuar më shumë te reklamat për medikamentet, si dhe tek emisionet për shëndetin. Situata e krijuar nga COVID-19 ka shtuar kohën programore nga OSHMA-të për aspekte të ndryshme të shëndetit.

Duke u nisur nga interesi për mbrojtjen e qytetarëve nga abuzimet me transmetimet për këtë temë, AMA ka realizuar shqyrtime me fokus të veçantë për medikamentet apo të trajtimit të çështjeve shëndetësore në përgjithësi. Për rastet e reklamave të fshehura, kur nuk janë zbatuar kërkesat e rregullores “Për komunikimet audio dhe/ose audiovizive me natyrë tregtare, format, kushtet dhe koha ditore e lejuar për transmetimin e reklamave”, si dhe zbatimi i kuadrit nënligjor në fuqi, që normon publicitetin e barnave, Autoriteti ka tërhequr vëmendjen e OSHMA-ve, si dhe ka qenë në komunikim të vazhdueshëm me Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

Mbrojtja e fëmijëve nga përmbajtjet e papërshtatshme ka vijuar të jetë në fokus të punës së Autoritetit dhe të monitorimit të përmbajtjeve audiovizive.

Për herë të parë në 21 vjet aktivitet AMA u angazhua drejtpërdrejt në monitorimin e mbulimit medietik të OSHMA-ve gjatë fushatës elektorale për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të datës 25 prill 2021. Më herët AMA vendoste në dispozicion të KQZ-së të gjithë infrastrukturën e saj. Me ndryshimet që u bënë, monitorimi i pasqyrimin të fushatës zgjedhore u konsiderua një sukses brenda radhëve të AMA-s, jo vetëm për faktin se raportet ishin burim

reference për raporte të monitoruesve vendas dhe ndërkombëtarë, por, mbi të gjitha, sepse nuk pati asnjë kundërshtim të gjetjeve të AMA-s prej operatorëve audio dhe audiovizivë.

Në tetor të vitit 2021 Autoriteti zhvilloi konferencën ndërkombëtare me temë “Mbrojtja e fëmijëve në mediet audiovizive”. Konferenca ishte organizuar në tri panele diskutimi, në të cilat referuan ekspertë nga Britania e Madhe, Belgjika, Gjermania, si dhe profesorë e ekspertë të fushës nga vendi dhe rajoni.

Autoriteti gjatë vitit 2021 ka vijuar praktikën e bashkëpunimit dhe mbështetjes së partnerëve në sektorin audio dhe audioviziv në vendin tonë. Autoriteti i Medieve Audiovizive ka financuar një sërë projektsh, disa prej të cilëve janë konkretizuar me botime librash apo broshurash.

Autoriteti i Medieve Audiovizive është pjesë e aleancës kundër gjuhës së urrejtjes, në përbërje të së cilës janë tri institucione të pavarura dhe një organizatë jofitimprurëse. Gjatë vitit 2021 aleanca ka vijuar takimet dhe diskutimet për dukurinë e gjuhës së urrejtjes dhe pasojat e saj në shoqëri. Gjithashtu, në bashkëpunimin me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është ndërmarrë një fushatë sensibilizuese për të sfiduar urrejtjen dhe diskriminimit në media, me qëllim ndërgjegjësimin e sa më shumë aktorëve apo elementëve të shoqërisë shqiptare.

AMA në muajin nëntor të 2021-it miratoi planin “numerik frekuencor”, siç njihet ndryshe DD2, apo digjital dividend 2, lirimi i brezit 700 për transmetimet audiovizive numerike tokësore në Republikën e Shqipërisë. Në zbatim të këtij vendimi, inicioi procesin e koordinimit të brezit UHF me vendet fqinje. Në momentin që flasim ky proces është drejt përfundimi për sa u përket vendeve fqinjëve.

Një rëndësi e veçantë i është kushtuar edhe përmirësimit të aseteve teknike pranë studios së monitorim dhe arshivës. Gjatë vitit 2021 u bë i mundur instalimi i pajisjeve të reja për regjistrimin e subjekteve audio në të gjithë territorin e vendit. Falë këtij investimi AMA tashmë mund të ndjekë në kohë reale tërësinë e programeve që transmetojnë të gjitha subjektet audio FM lokale, rajonale apo kombëtare.

Gjithashtu, në funksion të monitorimit të proceseve zgjedhore, u investua në sektorin e përpunimit të të dhënave në periudhën zgjedhore, duke bërë të mundur blerjen e një softi për përpunimin e të dhënave sasiore të subjekteve audio dhe audiovizive në transmetim. Programi u ndërtua mbi bazën e kërkesave dhe rekomandimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në metodologjinë për monitorimin e zgjedhjeve.

Në muajin korrik pata rastin të zhvilloja një takim pune në Vjenë me përfaqësuesen e lartë për lirinë e medias në OSBE, zonjën Teresa Ribeiro. Gjatë këtij takimi u përmendën

shtyllat kryesore të aktivitetit të Autoritetit, si mbrojtja dhe të drejtat e fëmijëve, mbrojtja e gazetarëve, të drejtat e autorit, të drejtat e transmetimit, transpozimi i direktivës së Bashkimit Europian 2018/1808 dhe çështje të tjera të hapësirës medietike, të cilat kërkojnë angazhim në vijimësi të Autoritetit të Medies. Pas një kohë të shkurtër, zonja Ribeiro ishte në Tiranë dhe u angazhua personalisht në konferencën ndërkombëtare të organizuar nga AMA.

Këshilli i ankesave pranë Autoritetit të Medieve Audiovizive gjatë vitit 2021, edhe pse me vijimin e pandemisë së krijuar nga COVID-19, në përmbushje të detyrave, objektivave të përcaktuara, angazhimeve dhe rekomandimeve të Kuvendit të Shqipërisë, ka vijuar mbikëqyrjen e zbatimit të kodit të transmetimit dhe të rregulloreve të miratuara nga AMA.

Gjatë gjithë periudhës raportuese këshilli i ankesave ka shqyrtuar mbi 300 ankesa, të ardhura nga individë, shoqata dhe organizata të shoqërisë civile. Pjesa më e madhe e shqetësimeve dhe ankesave të ardhura kishin si objekt të tyre shkeljen e të drejtave të njeriut, të normave ligjore dhe etike, shkeljen e të drejtave të fëmijëve, cenimin e dinjitetit, si dhe disa ankesa të shtuara ndaj rrjeteve sociale, portaleve dhe gazetave.

Në zbatim të rekomandimeve të Kuvendit të Shqipërisë gjatë vitit 2021, AMA ka lidhur 2 marrëveshje bashkëpunimi me institucione, aspektet e punës së të cilave lidhen me fushën e veprimit të Autoritetit, me qëllim krijimin e hapësirave dhe lehtësimin e formave të koordinimit të punës.

Autoriteti i Medieve Audiovizive dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare nënshkruan memorandumit e bashkëpunimit, me qëllim garantimin dhe mbështetjen operacionale, teknike dhe ligjore në fushat me interes të përbashkët për të dyja palët.

Gjithashtu, është nënshkruar marrëveshja e mirëkuptimit për bashkëpunimin dhe ndërveprimin ndërinstitucional mes Universitetit Politeknik të Tiranës dhe Autoritetit të Medieve Audiovizive. Ky material do t'i vijë në ndihmë AMA-s për përgatitjen paraprake për çështjet që do të diskutohen dhe miratohen në konferencën botërore të radiokomunikacionit, e cila do të zhvillohet në vitin 2023, çështje për të cilat administrata shqiptare, si anëtare me të drejta të plota në ITU, do të ketë vendimmarrje.

Pjesëtarë të stafit të AMA-s gjatë vitit 2021 kanë marrë pjesë në më shumë se 37 konferenca, takime, tryeza diskutimi brenda e jashtë vendit, me homologët dhe bashkëpunëtorët për tema, që lidhen me veprimtarinë e autoritetit.

Po ashtu gjatë vitit 2021 AMA, si në vitet e mëparshme, ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me homologët, në kuadër të pjesëmarrjes në organizmat evropianë apo rajonalë të medies audiovizive, si: EPRA, ERGA, REFRAM e të tjerë.

Unë preferova të shprehem kaq shkurt në fjalën time, duke ju falënderuar për vëmendjen dhe jam e hapur për pyetjet tuaja!

**Petro Koçi** – Faleminderit, zonja Krasniqi!

Mendoj të hapim seancën e pyetjeve dhe të komenteve.

Kush e do fjalën i pari?

Po, zoti Boçi, fjala për ju.

**Luçiano Boçi** – Faleminderit, zonja Krasniqi!

Ju dëgjova me vëmendje, por në parashtrimin tuaj nuk pashë gjëra esenciale në lidhje me aktivitetin e AMA-s, vetëm një panoramë takimesh dhe menaxhimi në pandemi, si një sukses.

Ky është ballafaqimi ynë i parë në këtë komision. Bashkë kemi qenë në ballafaqim kur ju keni qenë drejtuese e Agjencisë Telegrafike Shqiptare. Pyetja ime ndoshta do të duket si pa etikë nga anëtarët e komisionit, por në parashtrësën tuaj ju pretendoni se respektoni ligjin dhe, nëse unë i referohem ligjit, i gjithë ligjërimi juaj për ligjin dhe prania juaj këtu si kryetare e AMA-s rrëzohet dhe shkërmoqet, sepse ligji “Për mediet audiovizive”, në nenin 7 e përcakton qartë se anëtari i AMA-s, përfshirë edhe kryetarin e saj, nuk mund të jetë anëtar i një partie politike dhe nuk mund të ketë pasur angazhime politike, ndërkohë që ju qartazi keni qenë e angazhuar politikisht. Nëse je anëtare apo jo, nuk e verifikoj unë, sepse listat e anëtarësisë ndonjëherë janë sekret dhe nuk reklamohen, por ju keni qenë zëdhënëse e Kryeministrit, i cili është edhe kryetari i Partisë Socialiste. Ndaj, pozicioni juaj është i dyshimtë dhe relatimi juaj për mua nuk duhet të vazhdonte. Unë mendova se do të vinit këtu dhe do të jepnit dorëheqjen nga kryetare e AMA-s për të zbatuar ligjin. Pra, kur nuk zbatohet ligji themeltar për funksionimin e AMA-s, si mund të pretendohet që ju keni zbatuar ligjin në vazhdimësi?

Partia Demokratike e ka shfaqur pretendimin e saj edhe pas votimit në seancën plenare, por nisur nga përvoja ime e gjatë në këtë komision, në asnjë rast nuk kemi lejuar që anëtarët e AMA-s të kenë një *begrund* politik kaq të theksuar sa ju. Ndoshta, pas këtij parashtrimi vlera e pyetjeve të tjera bie, por unë dua t’i bëj, për të treguar gjendjen alarmante të Autoritetit në raport me mënyrën e menaxhimit të medias nga ju, në bazë të ligjit.

Pyetjet e mia janë këto:

“Reporterët pa kufij” kanë nxjerrë rankimin e vendeve, në bazë të respektimit të lirisë së medias, dhe Shqipëria rezulton të jetë 20 vende më poshtë dhe e fundit në rajon. A ka një korelacion mes kësaj rënie në lirinë e medias dhe të qenit tuaj si një person politik në krye të AMA-s, sepse keni 1 vit dhe për 1 vit ne kemi humbur 20 vende? Gjithashtu, duhet të argumentoni se çfarë keni bërë ju për të respektuar dhe imponuar lirinë e medias, sepse jeni

autoriteti kryesor, vetë e thatë se keni zhvilluar takime frekvente me drejtues të shoqatave dhe institucioneve, që garantojnë dhe sigurojnë lirinë e medias në demokraci të tilla si e jona në Europë apo në mbarë botën.

Në lidhje me lirinë e medias, ka pasur shumë raste të relatuar në medie, edhe nga shoqatat që ju keni lidhje të drejtpërdrejta, përpara se të dalin në medie, në të cilat theksohet se Kryeministri shpesh ka kaluar në gjuhë goditëse, dhunuese, përjashtuese, diskriminuese për gazetarë të televizioneve të caktuara. Nga Autoriteti nuk ka pasur asnjë reagim. Atëherë, si mund të pretendoni në raportin tuaj që ju mbron lirinë e shprehjes dhe të ushtrimit të profesionit të gazetarëve në rastet konkrete, kur të gjitha këto shoqata ndërkombëtare i evidentojnë rastet dhe i deklarojnë? Informacionet kanë dalë me raste konkrete për gazetarë konkretë, nuk është e drejta ime t'ju jap emra, sepse emrat i keni në tavolinë ose duhet t'i kishit, nëse nuk i keni, të cilët duhet t'i kishit relatuar si raste bashkë me procedurën dhe rrugën që ju do të kishit ndjekur në rastin kur garantoni lirinë e shprehjes dhe të trajtimit të gazetarëve, gjë që nuk e keni bërë.

Në lidhje me lirinë e medias dhe respektimin kundër diskriminimit, televizionet tona janë të mbushura plot me akte që transmetojnë dhunë, vrasje, aksidente, të pasqyruara qartazi, jepen imazhet e minorenëve në rastet kur ka abuzime me ta, ndërkohë në relacionin tuaj nuk dëgjova për raste konkrete, ku ju keni ndërhyrë në televizione, në OSHMA-ë, për të penguar transmetimin e pamjeve të tilla.

Pyetja tjetër ka të bëjë me industrinë farmaceutike. E kemi ngritur edhe herë të tjera, madje unë, edhe zoti Koçi, duke konsideruar një shqetësim të madh familjar, por edhe publik, se në televizionet tona, në mënyrë të shpeshtë transmetohen reklama për medikamente, të cilat nuk kanë marrë aprovimin e autoriteteve. Në Shqipëri duhet të ekzistojë një autoritet aprovues, sepse nuk jeni ju që aprovoni medikamentin. Në momentin që medikamenti nuk ka miratimin e autoriteteve, atëherë ju duhet të ndërhyni, që transmetimi të pengohet. Unë e di që industria farmaceutike, sidomos në periudhën e pandemisë, ka pasur një bum ekonomik të papërbalueshëm nga ju dhe intimidues për të gjitha televizionet. Pra, nuk shikoj të keni ndërhyrë, madje shikoj me shqetësim që reklamat janë shtuar nga një televizion në dy, në tre dhe në dhjetra televizione; çuditërisht edhe në transmetime serioze futen ndonjëherë reklama të medikamenteve, që janë edhe parafarmaceutikë dhe nuk dihet efekti i vërtetë. Gjëra të tilla nuk ndodhin në shtete të tjera. Ku është roli i AMA-s? Ju duhet t'u kërkonte llogari OSHMA-ve, që kanë marrë licencat frekuencore, që të ndërtojnë një kanal të dedikuar për reklama, sepse nuk ekziston, dhe të paguajnë atje. Në të gjithë botën ekziston një kanal i dedikuar për reklama të tilla. Nuk mund të bësh reklama të tilla te *news*-et, te programet artistike apo programet e

tjera për fëmijë, që prishin funksionimin e televizioneve. Në konsideratën time ju nuk keni bërë asgjë në këtë drejtim.

Në relacionin tuaj nuk përmendet asgjë për RTSH-në, ndërkohë që jeni autoritetit kryesor që duhet ta mbështetni atë. Prandaj thashë që relacioni juaj nuk vlen, është sipërfaqësor, është për të kaluar radhën, sinqerisht e them. Kam dëgjuar shpesh relatime në këtë komision dhe ky ka qenë relacioni më sipërfaqësor që kam dëgjuar ndonjëherë. Në raport me RTSH-në nuk keni thënë asgjë që të mendosh se atje ka një skandal, se ka një emërim jo të ligjshëm dhe ju nuk keni reaguar.

Këshilli i Radiotelevizionit Shqiptar mbikëqyret nga ju, nuk ka autoritet tjetër, nuk ka gjykatë që e mbikëqyr, por ju nuk kemi reaguar dhe keni pranuar që aty të bëhet një garë e pandershme. Ndaj sot në drejtimin e RTSH-së kemi një drejtues të paligjshëm, nuk ka rëndësi se cili është personi, por drejtori është i paligjshëm, sepse nuk është zgjedhur me të gjithë anëtarët e Këshillit Drejtues të RTSH-së, sikurse drejtuesi i Këshillit Drejtues nuk është zgjedhur me të gjithë anëtarët e Këshillit Drejtues të RTSH-së, ndërkohë që ligji, në mënyre laksative, e përcakton që duhet të jenë të gjithë anëtarët.

Meqenëse jemi te Radiotelevizioni Shqiptar, në dijeninë time ka ndodhur edhe herë të tjetra, nuk ka pasur reagim nga AMA, ka ndodhur përsëri, Radiotelevizioni Shqiptar ka blerë të drejtat televizive për aktivitetet sportive me paratë e publikut shqiptar dhe këto ia ka shitur një televizioni kombëtar privat. Ku është AMA, çfarë bën? Si mundet që një e drejtë televizive e blerë me paratë e publikut t'i kalojë si e drejtë ekskluzive një televizioni tjetër që nuk e ka blerë dot në treg, sepse, normal në të tilla gjëra favorizohet gjithmonë televizioni publik?

Në rastin konkret, kur RTSH-ja është lënë pas dore, është lënë *des affaires*, të bëhet çfarë të dojë atje me drejtuesit, me shitje dhe pa shitje, kur liria e medieëve është rrëzuar përtokë në Shqipëri, kur dhuna pushton ekranin, kur medikamentet e palicensuara vlojnë nëpër televizione, ndërkohë që gazetarët as nuk mbrohen, nuk kanë një autoritet ku të mbrohen, cili është funksioni i AMA-s?

Në rastin e fundit konkret, përderisa jeni kaq politike, zonjë, pse e nuk jepni dorëheqjen?

Faleminderit!

**Petro Koçi** – Fjalën jua jap unë.

Faleminderit, zoti Boçi!

Do të vijojmë në këtë mënyrë, pra, në varësi të numrit të pyetjeve ju do të përgjigjeni, pra meqë janë disa pyetje dhe komente nga zoti Boçi, do të përgjigjeni dhe më pas, nëse dikush



nga kolegët do të ketë më pak pyetje, do t'i përfshijmë pyetjet e dy kolegëve dhe të përgjigjeni ju për të mos e bërë tërkuzë.

Fjala për ju, zonja Krasniqi.

**Armela Krasniqi** – Procedurën e vendosni ju, ndërsa ne jemi këtu për t'iu përgjigjur të gjitha shqetësimeve tuaja.

Së pari, dua të falënderoj 83 deputetët e Kuvendit të Shqipërisë, të cilët votuan pozitivisht për kandidaturën time!

Së dyti, sa i përket konkluzioneve të raportit të fundit të Reporterëve pa Kufij. Siç është thënë në raportin vjetor, por edhe në raportimet periodike përmes të cilave është informuar vazhdimisht Kuvendi i Shqipërisë, AMA është një autoritet rregullator dhe nuk është një institucion që harton ligje. AMA shqyrton përmbajtjet e transmetuara, duke vlerësuar përputhshmërinë që ato kanë me ligjin apo nëse i plotësojnë apo jo kërkesat në përmbushje të Kodit të Transmetimeve, si dhe të akteve dhe rregulloreve të tjera që janë në fuqi.

Sa i takon përmirësimit të raportimit në media, më duhet t'ju them se AMA prej vitesh mbështet projektet dhe programet e kualifikimit, trajnimet e gazetarëve, të redaktorëve dhe të drejtuesve të redaksive. Ato kanë qenë të fokusuar te mbrojtja e të miturve nga përmbajtja e papërshtatshme, fenomeni *fake news* apo të formave të ndryshme të disinformimit, të barazisë gjinore, diskriminimit, gjuha kundër urrejtjes, përdorimit të shqipes standard në të folur dhe në të shkruar, mbulimit të fushatave elektorale e më tej, sepse nuk dua të zgjatem.

Kualifikimet dhe trajnimet janë orientuar jo vetëm në redaksitë e medieve qendrore, por edhe te mediet lokale, duke prekur kështu të gjithë hapësirën medietike ku ushtrohet profesioni i gazetarit në Shqipëri. Organizimi i eventeve të ndryshme me ekspertë më të mirë ndërkombëtarë, ka sjellë sigurisht një qasje më tutje sa i takon përmirësimit të dijes së gazetarëve. Më duhet t'ju them se ne aktualisht kemi depozituar në komisionin tuaj të nderuar një raport prej 85 faqesh. Unë nuk e di nëse ju zoti Boçi, keni pasur mundësinë apo kohën për ta parë të gjithë raportin, i cili është shumë i plotë dhe adreson një pjesë të shqetësimeve që ju i prekët, sidomos sa u takon akteve të dhunës ndaj fëmijëve, pamjet e dhunës, rastet kur minorenët janë të evidentuar me pamjen e tyre. Madje mund t'ju them që në të gjitha konferencat ndërkombëtare që ne kemi mbajtur për këtë çështje dhe pse janë bërë ato, ka qenë pikërisht sepse kemi dashur të ndërgjegjësojmë OSHMA-të në vend, sepse kanë qenë problem, një problem, të cilin nuk e keni evidentuar ju, por ne gjatë punës sonë të përditshme.

Periudha e raportimit për të cilën është ftuar Autoriteti sot për të folur, si dhe unë si kryetare e tij, bën fjalë për periudhën janar-dhjetor 2021. Ju kujtoj që detyra ime ka nisur në

korrik të vitit 2021, pra raportimi është për të gjithë periudhën vjetore, por nëse do të më adresoheshit personalisht është vetëm për 6 muaj.

Sa i takon pjesës së reklamave, mund t'ju them se është e vërtetë që kemi pasur një fluks të shtuar, ashtu siç jua thashë edhe në fjalën time, por do ta gjeni edhe në faqet e raportit, të reklamave për medikamentet dhe kjo ka ardhur për shkak të pandemisë Covid-19. Duhet të kini parasysh një gjë, që ne kemi pasur një komunikim të jashtëzakonshëm, të shtuar dhe të shpeshtë, madje edhe me *e-mail*-e dhe me letra zyrtare me Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore. Është pikërisht kjo agjenci, e cila na konfirmon ne nëse është ilaç, medikament apo është suplement ushqimor, pra këto janë dy gjëra të ndryshme. Pra, këtë gjë e vlerëson agjencia dhe jo AMA.

Sa i takon hapësirës së reklamave dhe kohës ditore të lejuar për to, mund t'ju them që Direktiva Europiane e 2018-s, e cila është implementuar tashmë në 27 vende të Bashkimit Europian në vitin 2020, pasi edhe në këto vende pati vështirësi për shkak të pandemisë për ta implementuar dhe për ta transpozuar në ligjet e tyre themeltare, ne tashmë kemi nisur punën së bashku me ekspertë të Bashkimit Europian për ta transpozuar këtë direktivë në ligjin organik të AMA-s dhe ndoshta në fund të vitit 2022 ju do të njiheni me draftin e parë të implementimit të kësaj direktive.

Dua t'ju them se sa i përket kohës së reklamave në mediat audiovizive, direktiva e re europiane është shumë liberale sa i takon kohës së lejuar, pra e normon ndryshe nga ligji organik i AMA-s, i reklamave në një orar të caktuar. Pra, nëse gjatë 1 ore sot lejohen deri në 12 minuta reklama, direktiva e re europiane, e cila shpresojmë të implementohet edhe në ligjin organik të AMA-s, ka një liberalizim të kohës së lejuar të reklamave, pra u jep më shumë fleksibilitet vetë OSHMA-ve në përcaktimin e vendosjes së reklamave në momentin që ata mendojnë që janë më vizibël apo sjellin më shumë informacion te publiku. Koha e vendosjes së reklamës tashmë, edhe në sajë të Direktivës Europiane, është liberalizuar së shumti.

Sa i takon RTSH-së, më duhet t'ju them që jemi në fazën që i mbaron kontrata 5-vjeçare me institucionin dhe duhet rinovuar kontrata e re dhe në të cilën përcaktohet kontrata e shërbimit të transmetuesit publik.

Po jua lexoj ligjin: “Përcakton natyrën dhe numrin e orareve të programeve të transmetimit për të mitur, natyrën e numrit të orëve dhe të programeve të transmetimit për shkencë, teknologji, botime që duhet të përgatisë, të botojë dhe të shpërndajë në përputhje...”

Pra, AMA nënshkruan kontratën e shërbimit me transmetuesin publik ose kërkon rishikim të saj brenda 30 ditëve nga paraqitja.

Zoti Boçi, unë nuk e di se ku e gjeni ju këtë në hapësirën e ligjit, e ftoj juristen të më ndihmojë, që ne paskemi të drejtë të kundërshtojmë zgjedhjen e drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së, pasi unë di që RTSH-ja është një institucion autonom.

**Sara Xhumbari** – Ligji i ka kushtuar një kre të posaçëm operatorit publik dhe mënyrës së funksionimit të tij. Këshilli Drejtues i Radiotelevizionit Shqiptar ka kompetencën të miratojë ndër dokumentet e tjera edhe statutin, ku parashikohen edhe rregullat për zgjedhjen, si për kryetarin ashtu edhe për drejtorin e Përgjithshëm dhe strukturat e veta të administrimit. Gjatë ushtrimit të aktivitetit administrativ nga ana e RTSH-së, nuk ka detyrim ligjor që të merret konfirmim ose të notifikohet procedura e zgjedhjes së strukturave të veta drejtuese pranë autoritetit tonë rregullator.

**Luçiano Boçi** – A mbaruat?

**Armela Krasniqi** - Besoj se po.

**Petro Koçi** – Po, zoti Boçi, vetëm shkurtimisht.

**Luçiano Boçi** – E di shumë mirë që RTSH-ja është e pavarur në veprimtarinë e saj, por ligji parashikon që ju jeni autoritet që ndihmoni në ngritjen e nivelit të funksionimit të RTSH-së.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Po, e keni të përcaktuar në detyrat konkrete, kështu që mos bëni sikur atje bëhet çfarë duan ata dhe ju nuk keni asnjë lloj përgjegjësie.

Cilësia e RTSH-së varet edhe nga mënyra si funksionon dhe se si e orienton AMA. Në këtë interkomunikim reagimet tuaja për rastet e shkeljeve ligjore nuk duhet thënë që duhet të qëndrojnë atje brenda, por duhet të bëhen të ditura që të parandalohen dhe ndoshta të orientohen për një zgjidhje ligjore, e keni të përcaktuar, kështu që përgjigjja në të tilla raste nuk vlen.

Për pjesën që nuk më dhatë përgjigje, ishte pyetja ime e parë dhe kryesore, në bazë të ligjit, iu referova nenit 7, në të cilin thuhet se çdo anëtar i AMA-s nuk duhet të jetë anëtar i një partie politike dhe të mos ketë pasur aktivitet politik. Siç jua thashë, ju keni qenë zëdhënese e kryetarit të Partisë Socialiste. A ma interpretoni dot ligjin? Ju veproni në bazë të ligjit për mediat audiovizive, prandaj dua një përgjigje. Kur u zgjodhët, falënderuat 83 deputetët, por mendoj se duhej të falënderoje edhe ata që nuk ta dhanë votën, ata që e dhanë kundër, sepse ata të kanë mësuar më shumë gjëra sesa ata që ta kanë dhënë votën pro. Megjithatë, nuk ka ndonjë gjë, sepse ti e ke falënderimin vetëm për ata që ta kanë dhënë votën pro, normal përderisa vjen nga PS-ja do të falënderosh ata të PS-së, kjo është logjike dhe unë e pranoj.

A e keni ju në konsideratë ligjin, sepse ju pretendoni për ligjin? Si e interpretoni? E kishit votuar kundër, zonjë, në qoftë se mendoni që Desada Metaj është një anëtare, madje nuk mund të ballafaqohet rasti...

Ju lutem, sot kemi kryetaren e AMA-s, por kur të vij Desada këtu, do t'ia them unë i pari. Dakord e bëjmë me marrëveshje?

**Petro Koçi** – E kaluam.

**Luçiano Boçi** – E kaluat ju, atëherë kjo është përgjegjësia juaj.

Unë nuk kam kaluar gjë.

Mos u fusni kot te Desada dhe të kapeni pas fijeve të barit si i mbyturi. Ne kemi këtu kryetaren e AMA-s dhe ju thoni gjë tjetër. Mua më vjen mirë për një gjë, që e pranoni që ka qenë zëdhënëse e Partisë Socialiste duke bërë korrelacionin me Desadën, është pranimi i faktit, por ama ky fakt duhet të na bëjë ne të ulërasim. Ligji e thotë ndryshe, atëherë si mund të vazhdojmë ne me një kryetare e AMA-s, e cila është zëdhënësjja e kryetarit të Partisë Socialiste. Ku jemi me ligjin? A jemi ne gardianët e ligjit? Ne jemi komisioni që mbron ligjin për mediat audiovizive, atëherë si mund të vazhdojmë më tej me zbatimin e ligjit të iksit, ipsilon dhe zeta?

Pyetja tjetër ishte: a ka korrelacion midis të qenit tuaj si politikane, ose e paligjshme dhe të rënies së Shqipërisë në rankimin e lirisë së medias? Pse jo? Cilat janë reagimet tuaja në raport me dhunimet e gazetarëve, sepse e keni në funksion që ju kryeni balancimin, ju keni Këshillin e Ankesave, ju madje penalizoni edhe mediat *online*, si dhe parashikohen edhe shumë gjëra? Unë për këto doja që ju të përgjigjeshin, sidomos për pyetjen e parë, sa i takon çështjes së konfliktit të interesit që ju keni, më pas edhe për lirinë e mediave. A ka korrelacion? A mendoni që ka? Nëse ju mendoni që nuk ka, thuajeni që nuk ka, sepse mediat në Shqipëri lulëzojnë, shkëlqejnë, nuk janë të kapura, nuk blihen, nuk trysnohen, nuk dhunohen, por raportet ndërkombëtare na tregojnë diçka tjetër.

Sa i takon pyetjes që nuk i dhatë përgjigje ishte: a keni dijeni që Radiotelevizioni Shqiptar ka marrë të drejta televizive? Janë 3 pyetje që nuk u keni dhënë përgjigje. Ka blerë të drejta televizive. I doni edhe të drejtat televizive?

Ka blerë për Lojërat Dimërore dhe ia ka shitur një televizioni tjetër privat kombëtar. A keni dijeni, a keni vepruar? A e lejon ligji në fund fare që me paratë e publikut të blihet një e drejtë televizive dhe t'i jepet një subjekti që ai t'ia shesë prapë publikut?

Pra, unë si publik e blej 2 herë të drejtën televizive, kur ia jap taksën RTSH-së, që e blen të drejtën televizive, sepse e kam te fatura e dritave, dhe kur unë blej paketën iks apo ipsilon se nuk e shoh dot te RTSH-ja, sepse RTSH-ja ia ka shitur atij subjektit privat. Si ju duket kjo? A keni ndërhyrë kur e keni evidentuar?

Nuk janë vetëm Lojërat Dimërore, është bërë një herë këtu në këtë komision nami për Kampionatin European para disa vitesh, kur ka qenë zoti Sala drejtues i AMA-s, i cili është detyruar të pranojë dhe të ndërhyjë, ndërkohë që janë shitur 2 të drejta televizive në këtë lloj forme. Unë dua reagimin tuaj.

Faleminderit!

**Petro Koçi** – Faleminderit, zoti Boçi!

Ju ftoj të përgjigjeni për çështjen e fundit, pasi ato të tjerat ishin pak personale...

**Luçiano Boçi** – Unë i referohem ligjit, ju thoni personale!

**Petro Koçi** – Nuk do të marrim në pyetje deputetët që votuan.

**Luçiano Boçi** – Jo deputetët, ajo vetë është e angazhuar politikisht, e ka lexuar ligjin. Unë nuk mund të vi e të bëhem nesër drejtues i AMA-s...

**Petro Koçi** – Kjo është çështje që duhej ngritur atëherë kur është bërë zgjedhja, sepse nuk ke çfarë t'i bësh tani.

**Luçiano Boçi** – Nuk kemi çfarë t'i bëjmë...

**Petro Koçi** – Jo, fare...

**Luçiano Boçi** – ... se ne e kemi bërë shkeljen e ligjit...

**Petro Koçi** – Jo, nuk ju thashë kështu.

Ky shqetësim duhej ngritur në momentin e duhur, sepse nuk mund të japë përgjigje...

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Luçiano Boçi** – Sot është rasti i parë...

**Petro Koçi** - Po dalim prapë në një çështje politike. Ju dëgjova edhe më parë që thatë sillen fasadë. Opozitën fasadë e gjetëm në listat e...

**Luçiano Boçi** – Nuk thashë fasadë.

**Petro Koçi** – U tha këtu një koment.

Unë mendoj që çështja e shitjes së të drejtës televizive blerë nga Radiotelevizioni Shqiptar dhe shitur një privati, është një çështje shumë e rëndësishme, ndërsa të tjerat kanë politikë. A mund t'i përgjigjeni kësaj pyetjeje dhe më pas do të vijojmë me pyetjet e tjera.

**Sara Xhumbari** – Lidhur me kontratat për kalimin e të drejtave...

**Luçiano Boçi** – Situata është e tillë dhe ju pranoni që jeni e implikuar politikisht...

**Sara Xhumbari** -...të transmetimit nga operatori publik. Lidhjen mes tarifës së aparatit të përdorimit për përdorimin e aparatit marrës televiziv e përcakton ligji, pra që tarifa që i paguhet RTSH-së është për përdorimin e aparatit televiziv. Sa u përket të drejtave të transmetimit, ligji në nenin 127 përcakton një kategori përmbajtjesh, të cilat konsiderohen me rëndësi të madhe për publikun, pra një listë ngjarjesh që konsiderohen me rëndësi për publikun

dhe të cilat publiku duhet t'i shohë pa pagesë. Në zbatim të kësaj dispozita ligjore, në vitin 2019 AMA ka miratuar një vendim ku janë identifikuar dhe përcaktuar të gjitha programet, të cilat konsiderohen me rëndësi për publikun, kryesisht janë programe me natyrë sportive ku merr pjesë kryesisht ekipi për disiplinat sportive në të cilat merr pjesë ekipi kombëtar.

Sa u përket të drejtave të transmetimit operatori publik është OSHMA-ja, që është njësoj si të tjerët dhe ka të drejtë të konkurrojë për marrjen e të drejtave për evente të ndryshme sportive.

Lidhur me kalimin e të drejtave, është ligji "Për sportin" që u jep të drejtën marrësve dhe mbajtësve të të drejtave për t'i kaluar ose organizatorëve të eventeve. Pra, pranë AMA-s, OSHMA-RTSH, në qoftë se operatorin publik e konsiderojmë si OSHMA, pra njësoj si privatët, ka detyrimin të depozitohet kontratat me të cilat ka marrë të drejtat e transmetimit në mënyrë që në momentin që i transmeton këto evente t'i gëzojë të drejtat e transmetimit të tyre.

**Petro Koçi – Faleminderit!**

Fjalën e kanë kërkuar disa kolegë, zonja Tahiraj, zonja Ulliri, zoti Ajazi dhe zonjat Zhupa dhe Tase.

Së pari, do t'ju bëj edhe unë disa pyetje që lidhen me diskutimin e sotëm. Dua të di, a keni ju presion nga subjektet e medias audiovizive, kur në përputhje me ligjin vendosni sanksione dhe të ndodhë që përveç këtij presioni të mundshëm të kemi edhe ndërhyrje nga ana e politikës?

Së dyti, besoj se e keni parë raportin që ka bërë bordi i monitorimit për veprimtarinë tuaj. Çfarë konsiderate keni ju si Autoritet për këtë draft që na ka ardhur, apo nuk keni? Nuk e keni, atëherë pyetja nuk qëndron.

Po ju bëj një pyetje tjetër. Çfarë mund të bëj AMA më shumë për të mbrojtur të drejtat e gazetarëve? Kjo është një çështje që është diskutuar në shumë tryeza ku ne kemi qenë prezentë, duke përbërë një shqetësim shumë të madh, madje kemi qenë me një pjesë të kolegëve kur kjo çështje është diskutuar.

Çështja tjetër ka të bëjë me kontributin e mundshëm që ka AMA, e cila në bashkëpunim me institucionet e tjera të rrisë transparencën mbi pronësinë e medias? Këtë e keni edhe si rekomandim dhe sipas raportit që ka ardhur këtu është një rekomandim në proces.

Pyetja tjetër ka të bëjë me situatën në të cilën ndodhet Shqipëria sa i takon lirisë së shprehjes. Sipas raportit që ne kemi këtu, *Freedom House* dhe *Reportes Without Bordes* kanë rritur pikët e vlerësimit të Shqipërisë për lirinë e shprehjes. Pse mund të ketë ndodhur kjo dhe çfarë mund të bëjmë më shumë që nga 1 ose pak pikë të kemi rritje të mëtejshme të lirisë së shprehjes si vlerësim nga institucionet ndërkombëtare? Këtu dua të bëj një ndërhyrje lidhur me

faktin që Komisioni i Venecias i ka kërkuar Shqipërisë që të mos bëhet asnjë ndërhyrje në ligjin për mediet dhe nëse bëhet ndërhyrje të jetë konformë gjykimeve dhe relacioneve që ka dhënë ky komision. Këtë e kam për referencë, sidomos për kolegët këtu.

Meqenëse pyetjet që unë bëra janë 4, atëherë po ia jap fjalën zonjës Tahiraj, që të bashkohen pyetjet e dy kolegëve për t'u përgjigjur. Më pas fjalën do t'ia jap dy kolegëve të tjerë zonjës Ulliri dhe zotit Ajazi.

**Dasantila Tahiraj** – Faleminderit, kryetar!

Në fakt, zonja Krasniqi në prill të këtij viti lançoi nisjen e punës për rishikimin e kodit të transmetimit, unë e vlerësoj shumë këtë fakt, pra që vetëm pas 8 muajve punë në krye të këtij institucioni nisi një diskutim të gjerë në të cilin merrnin pjesë përfaqësues të medieve, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues nga bota akademike dhe mbi të gjitha kishte shumë ekspertë të huaj, sepse pata fatin të isha pjesë e këtyre diskutimeve për një kod transmetimi me një gjuhë më të butë me një ulje të gjuhës së urrejtjes, me një kod transmetimi në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve, të barazisë gjinore, gjithashtu, dhe shumë diskutime të tjera. Pa dyshim kjo është një gjë shumë e rëndësishme, sepse kodi aktual është miratuar në vitin 2017. Gjatë këtyre 5 vjetëve ka ndryshuar shumë gjëra dhe për shkak të situatës pandemike, por edhe për shumë arsye të tjera kur ne do ta kemi gati këtë kod të ri transmetimi?

Së dyti, a ka ndonjë politikë AMA për të ruajtur të drejtat e gazetarëve nga pronarët e medieve? Sa herë kemi qenë në tryeza bisedimi me gazetarët, ata kanë të gjithë lirinë e plotë të flasin në lidhje për çdo gjë tjetër pra me të gjitha institucionet dhe politikat që ndiqen, por ato ankohen se nuk kanë mundësi të mbrojnë të drejtat e tyre nga pronarët e medieve, duke thënë se madje shpeshherë nuk bëjnë lejen që i takon, shpeshherë nuk i paguhen ditët që iu takojnë t'i kenë pushim, dhe shumë të tjera. Pra, a ka ndonjë politikë specifike AMA për të rritur nivelin e mbrojtjes së gazetarëve në lidhje me pronarët e medieve?

Faleminderit!

**Petro Koçi** - Fjala për ju zonja Krasniqi.

**Armela Krasniqi** – Unë do të flas për periudhën që unë e drejtoj AMA-n. Sa i përket pyetjes suaj për presionet nga OSHMA-të, ose presione të ndryshme nga drejtime të tjera jo vetëm nga televizionet, e radiot unë dua të them se vetëm dy muaj pasi mora detyrën si kryetare e AMA-s mbi tavolinën time ishin vendosur 8 dosje me 8 sanksione për OSHMA-të më kryesore në vend, flas këtu për televizione, platforma dhe madje edhe ndaj televizionit publik. Patjetër të gjitha këto sanksione të cilat administrata i kishte vlerësuar si të drejta u miratuan në bordin e AMA-s. Unë nuk mund të dëshmoj deri në këto momente për ndonjë presion nga

OSHMA-të ose drejtime të tjera pasi ne kemi respektuar ligjin dhe kemi dhënë për gjatë një viti 13 penalitete të tilla, kryesisht sa i takon të drejtës së transmetimit.

Ndërsa në aspekte të tjera ku kemi vënë re cenim të dinjitetit të fëmijës ose cenim të dinjitetit të një zonje dhe raste të ngjashme me kemi ndërhyrë me OSHMA-të përkatëse dhe kemi vepruar në operativitet pa pritur për të çuar shkresa dhe kohën e marrjes së përgjigjes nga ata, pra kemi vepruar përmes emaliit drejtpërsëdrejti me bordin e etikës që secila OSHMA, e ka edhe këmbënguljes së AMA-s. Kështu që në këtë aspekt mund të them se nuk kemi pasur presione.

Sa iu takon të drejtave të gazetarëve pyetja juaj, në fakt, është e vërtetë është një shqetësim i ligjshëm që vjen nga gazetarët. Ne si AMA, në bazë të ligjit organik nr. 97/ 2013, ju e dini tashmë të gjithë se në të gjitha direktivat flitet shumë për vetërregulim, kemi hapur thirrje për të mbështetur me projekte këtë ngërç nëse mund të ekzistojë në disa OSHMA, që të jenë vetë shoqatat e gazetarëve dhe unioni i gazetarëve ose organizata të ndryshme, të cilat përfaqësojnë gazetarët ose punonjësit e medias në tërësi, të cilët të hartojnë vetë një kontratë pune të gazetarit. Mund të them se ky ishte një projekt i nisur para se unë të merrja detyrën, por nuk u realizua dot për arsye të pandemisë dhe përsëri ne e kemi hapur si thirrje dhe jemi gati të mbështesim çdo iniciativë në këtë drejtim, por duhet të kuptojmë të gjithë së bashku që AMA është rregullatore, ajo nuk mund të hartojë kontrata ligjore që t'i thotë OSHMA-ve të zbatojnë këtë kontratë me gazetarët e tyre. Kjo është një gjë që duhet të vijë nga vetë organizatat e gazetarëve. Ne jemi në kërkim të një kontributi të tillë, që më pas pasi kjo kontratë të hartohet nga vetë subjektet dhe aktorët e fushës të jetë e mundur të shpërndahet dhe të publikohet dhe të integrohet në strukturat e OSHMA-ve.

Çfarë mund të bëjmë më shumë për lirinë e medias? Media është shumë e gjerë, zoti Koçi. AMA ka vetëm audiot dhe audivizivet, që do të thotë audiot dhe televizionet. Personalisht si një gazetarë që vij nga fusha e terrenit dhe pastaj në drejtimin e redaksive të ndryshme mund të them se, në fakt, ka ecur shumë përpara fusha e lirisë së medias, megjithatë nëse ju shikoni se ka momente, të cilat duhen përmirësuar patjetër është në të drejtën e ligjvënësit që ta përmirësojë ligjin organik të AMA-s, por me ligjin aktual AMA, përgjigjet vetëm për pika të cilat ia lejon ligji të veprojë.

**Petro Koçi** – Po, zoti Muka.

**Arben Muka** – Sa i përket pyetjes suaj, zoti Koçi, për pjesën e transparencës së pronësisë së medias AMA ka një produkt, i cili është edhe virtual, është edhe softcopi edhe hardcopi, është buletini periodik, i cili hyn tek ato elemente, që e kanë vlerësuar pak edhe institucionet ndërkombëtare që monitorojnë zhvillimet në Shqipëri, i cili ka një set treguesish



nga tregu audio dhe audioviziv ku përfshihet edhe pronësia e medias, që do të thotë se janë të dhëna mbi pronësinë e medias sigurisht të deklaruara. AMA nuk është institucion hetimor që të thotë se Arbeni është pronari apo i afërmi, por bën deklarimin patjetër të asaj që ka depozituar OASHMA-ja ose subjekti audioviziv në institucionet e tjera dhe që paraqet edhe te AMA kur bënë pjesën e marrjes së licencës.

Treguesi tjetër, që unë mendoj se është shumë i rëndësishëm, është se ne nxjerrim një tregues ku Arbeni që është pjesëmarrës aksioner ose bashkaksioner tregon çfarë interesash ka këtu dhe në pjesë të tjera të industrisë, këto janë në mënyrë transparente. Sigurisht ai që i lexon, i studion. Pra, kërkuesit, ata që janë të interesuar, ligjvënësi, shoqëria civile i ka në mënyrë transparente. Ky është një element te pjesa e pronësisë plus pastaj është edhe procedura. Drejtoresha juridike mund t'ju sqarojë që kur bëhet pjesa e aplikimit ndiqen edhe disa rregulla që nëse ke aksione janë të kufizuara. Kjo është në përputhje me ligjin.

**Armela Krasniqi** – Përdorimi i teknologjisë digjitale ka krijuar mundësinë për shfrytëzimin efektiv të frekuencave duke sjellë kështu rritjen e numrit të shërbimeve programore të subjekteve. Kur flas për programe e kam fjalën për kanale të mirëfillta dhe përveç 5 operatorëve privatë kombëtarë, që ofrojnë 75 programe audiovizive, pra do të thotë 75 kanale të tilla me një peshë të rëndësishme në pluralizimin e shërbimeve programore e zë edhe operatori publik RTSH-ja, i cili ka 14 kanale. Përveç transmetimit të këtyre, që janë numerike, realisht tregu audioviziv tashmë, le të themi, për shkak edhe të zhvillimeve të teknologjisë është i orientuar drejt përdorimit të shërbimeve të reja për të cilat, në fakt, këtu dua të ndaloj, nuk parashikohet asnjë kufizim ligjor sa i përket pronësisë flas për IPTV-të, OTT-të, ose interbet TV-të. Të gjitha këto shërbime autorizohen pasi nuk ka asnjë garë mirëfilli për to. Nëse për rrjetin numerik gjithmonë hapet një garë, ndërkohë këtu ligjvënësi është treguar më liberal dhe për këto shërbime është shumë e thjeshtë për të marrë një autorizim pasi këto shërbime në internet mund të merren me një autorizim në bazë të kriterëve, por nuk ka kufizime fare në pronësi.

Në këtë mënyrë unë mendoj se sigurohet praktikisht jo vetëm një pluralizëm në tregun medietik, sepse 75 kanale, plus 14 të televizionit publik, përveç shumë televizioneve që ne i shohim në platforma, por ato janë në fakt IPTV-të, por dhe ka një shumëllojshmëri tregu dhe në këtë rast nuk mund të flitet për një situatë monopoli në tregun e transmetimeve audiovizive.

Sa i takon kodit të transmetimit, është një domosdoshmëri për t'u rishikuar, në fakt është një akt nënligjor, por me çfarë kemi parë nga ankesat e shumta unë ju thashë vetëm gjatë vitit 2021 kemi pasur 330 ankesa. Këshilli i ankesave është një strukturë vetëm me tri veta dhe ka përpunuar 300 ankesa që prekin kodin e transmetimit, por çështjet janë nga më të ndryshmet,

diskriminim, gjuhë urrejtjeje, gjuhë e papërshtatshme, përmbajtjeje të papërshtatshme, ekspozimi i viktimës së krimit seksual, ekspozimi i fëmijës me probleme të shëndetit mendor, ekspozimi i fëmijës me aftësi të kufizuara. Të gjitha këto kanë kërkuar një angazhim maksimal të këshillit të ankesave. Por nga krahu tjetër është vënë re që, në fakt, pavarësisht si donim në t'i adresonim brenda këtij akti nënligjor kishte shumë çështje, të cilat nuk adresoheshin brenda kodit të transmetimit, kjo sepse kodi është miratuar në vitin 2017, por sa i takon zhvillimit të teknologjisë ky vit është larg, dhe nuk mund të gjenin reflektim në kodin e transmetimit pasi nuk ishin çështje që vërtetë ishin pjesë e zhargonit tonë të përditshëm për këtë arsye ka nisur puna për kodin e transmetimit. Unë ju falënderoj për pyetjen tuaj. Unë do të ftoj të gjithë anëtarët e komisionit pasi do ta çmoja me shumë vlerë çdo kontribut në këtë kod. AMA nuk do ta bëjë vetëm këtë kod përveç shoqatave organizatave jofitimprurëse që ju patë atë ditë ne do të zhvillojmë tryeza të tjera për kodin e transmetimit pasi është kërkuar që të ketë seksione të veçanta për gjuhën seksiste në medie. Po ashtu AMA për mbrojtjen e fëmijëve ka kërkuar që të ketë sanksione dhe ndalime në kodin e ri të transmetimit. Kodi i ri do të doja të bëhej brenda vitit të ardhshëm, por do të kalojë më parë në sitën e OSBE-së dhe këshillit të Europës pasi janë dy organizma me të cilat AMA ka bashkëpunim tërësor. Kodi i transmetimit nuk do të kalojë, gjithashtu, pa u shoshitur mirë në redaksitë e lajmeve dhe të programeve, pasi pjesën më të madhe të peshës në ankesat tona e zënë programet.

Me dëshirën e madhe që ne at përfundojmë vitin tjetër, por duam të hartojmë një kod sa më në përshtatje me kohën dhe t'i rezistojë kohës. Nëse shoqatat do të kërkojnë edhe ndryshime ligjore, kjo nuk është më kompetencë e AMA-s dhe besoj do t'ju drejtohem ju.

*(Vijon drejtimin e mbledhjes kryetarja e Komisionit, znj. Flutura Aça.)*

**Flutura Aça** –Faleminderit!

Zoti Koçi ka një ndërhyrje të vogël.

**Petro Koçi** – Meqë po e ndiqja dhe për mua është me shumë interes çështja e pronësisë mbi median. Ne kemi një sistem, i cili është në konflikt interesi, por nuk është se varet nga ju, kjo varet nga ligjvënësi, sepse ne i lejojmë pronarëve të medias që të kenë mundësi dhe akses mbi financat publike. Kjo është çështja kryesore që pengon edhe lirinë e shprehjes, edhe e bën të gjithë këtë mekanizëm të mos jetë demokratik sa duhet të jetë.

Unë ju falënderoj për përgjigjet për aspektet juridike dhe teknike të përcaktimit dhe rritjes së transparencës për pronësinë e medias.

**Armela Krasniqi** - Në ligjin tonë është e parashikuar që asnjë nga OSHMA-të nuk mund të ketë më tepër se 30 % të reklamave mbi tregun e medieve audivizive. AMA dhe

drejtoria e programeve është shumë e vëmendshme dhe mund t'ju them se të gjitha shqyrtimet dhe monitorimet tona janë të publikuara në faqen e internetit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Petro Koçi** – Ka lidhje me tenderët publike dhe financat publike, sepse puna e reklamave është gjë tjetër.

**Flutura Aça** - Zonja Tase.

**Eralda Tase** - Faleminderit!

Unë jam deputete e qarkut të Fierit dhe jam e interesuar si e mendoni ta rigjallëroni medien lokale? Po flas për qarkun e Fierit duke qenë se e njoh më mirë dhe në qytetin e Lushnjës nuk ka asnjë televizion që funksionon, vetëm një radio, dhe në Fier vetëm para 2-3 muajsh është mbyllur edhe televizioni i fundit për shkak të taksimit të shumëfishtë, për të drejtë e autorit, taksën lokale, për pagesën e RTSH-së tatim- fitimin, të gjitha këto i aknë çuar mediet lokale në faliment. Flas edhe për televizionin AVN që është krijuar në vitin 1994 dhe atëherë nuk ka pasur AMA, por sot është i mbyllur. AMA do të funksionojë për të kontrolluar vetëm Klanin dhe Top Chanal.

A ka ndikuar AMA në mbështetjen dhe ndihmën e fëmijëve me aftësi dhe nevoja të ndryshme?

Si shpërndahet reklama shtetërore? Kush e merr? Tregu i reklamave private kontrollohet nga 2-3 agjenci, dhe nga këto njëra i përket vëllait të Erion Veliajt. Këto agjenci i rekomandojnë televizionet se ku t'i çojnë reklamat. Pra, këto agjenci reklamash përdoren si mjete të drejtimit të tregut duke pasuruar disa dhe duke falimentuar disa të tjerë. Po kështu edhe reklamat shtetërore, ministri AZHBR, e të tjera dërgohen vetëm në disa vende dhe jo tek të gjithë. A ka ndonjë studim a hetim të AMA-s për këtë?

**Armela Krasniqi** – Sa i përket medias lokale unë do t'ju them se pas procesit të digjitalizimit, i cili përfundoi në vitin 2020 është e vërtetë ajo që thoni ju që shumë nga subjekte të cilat më parë operonin si televizione lokale vendosën të ndryshonin formën, pro jo përmbajtjen e tyre. Kjo do të thotë që u transformuan në ofrues të shërbimit me kabull pasi për shkak të situatës, sepse nuk shlyenin dot detyrimet ose e menduan se është më fitimprurëse kështu u orientuan drejt këtij shërbimi por në fakt unë mund t'ju them se në fakt janë të mbuluara këto zona që ju përmendni. Sa i takon AVN-së që ju thoni që ka që nga viti 1994 është e vërtetë që ajo ka pasur një problem që nuk shlyente detyrimet pranë AMA-s. Nëse ju mendoni se këto detyrime janë të larta kjo është një pjesë e punës sonë që ne mund ta rishohim të gjithë së bashku, nëse ju mendoni.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Por ndërkohë janë duke lulëzuar të tjerë të cilët janë orientuar drejt teknologjisë digjitale dhe ka shumë televizione që kanë orientuar të gjithë shërbimin e tyre dhe ka IPTV

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në Fier është “TV Apollon” që ka hequr dorë. Zonën e ofrimit të shërbimit e ka për qarkun e Fierit dhe qarkun e Vlorës.

Ndërkohë AMA nuk ka njoftuar...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Lidhur me qarkun e Fierit, AVN-ja...

**Eralda Bano** – “TV Apollon”, po flas për qarkun e Fierit, praktikisht është i mbyllur si biznes, nuk funksionon. Ku e ka çuar biznesin?

**Armela Krasniqi** – “TV Apollon” është një subjekt i pajisur me licencë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Po jua them të gjitha, meqë edhe unë jam nga ajo zonë dhe kam informacion për të gjitha subjektet e licencuara.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Në Lushnje kemi subjekt, është “TV4 Plus”.

Në Fier ka disa subjekte, të cilat, pavarësisht se e kanë licencën, është zgjedhja e tyre nëse ofrojnë shërbim, apo jo. Për shembull, ne kemi subjektin “TV Jug” në Fier, dhe në mënyrë të përsëritur i kërkojmë këtij televizioni të postojë dokumentacionin, që në qoftë se nuk do të jetë me licencë, të jetë me autorizim. Pra, subjekteve u krijohet çdolvoj lehtësie nga ana jonë për të ofruar shërbim.

**Eralda Bano** –Thelbi dhe pyetja ime ishte që këto televizione kanë falimentuar për shkak të taksave të shumëfishta. Ju çfarë do të bëni në këtë drejtim? Kjo është pyetja themelore dhe logjike që unë kam për ju kërkoj.

**Armela Krasniqi** – AMA është rregullatore dhe ne kemi disa pagesa që na i cakton ligji, është një dispozitë fikse në ligj, që thotë se çfarë paguhet nga AMA është pagesa vjetore për licencë vetëm nga AMA. Ndërkohë, detyrimet tatimore rregullohen me legjislacionin fiskal. Detyrimet vendore rregullohen nga ligji “Për qeverisjen vendore” nga bashkia, pra është jashtë tagrit të AMA-s. Ne kemi pasur raste kur kemi ndërhyrë edhe në formë shkresore, ku kryesisht operatorët kabllorë e kanë parashtruar këtë shqetësim lidhur me taksat vendore të bashkive që aplikohen. Ka pasur ndërhyrje nga ana e AMA-s, ku është kërkuar rishikimi i tarifave në mënyrë që të mbështetet aktiviteti i tyre.

Edhe tarifat tona janë në proces rishikimi në mënyrë periodike.

Faleminderit!

**Eralda Bano** – Sa i përket reklamës shtetërore, në ligjin nr. 97/2013...

**Arben Muka** – Ky problem është reflektim i dy aktiviteteve që kemi bërë për kodin e transmetimit. Pyetja është me shumë vend. Në fakt kodi aktual i ka të përcaktuar personat me aftësi të kufizuar, por është shumë i drejtë shqetësimi juaj, që është edhe më alarmant për fëmijët me aftësi të kufizuara. Sigurisht që...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Patjetër! Edhe shqyrtimi që u bëhet këtyre rasteve sipas ankesave apo shqyrtimeve që bëjmë ne...

Përmirësimi i kodit do të ketë një evoluim për specifikimin për fëmijët me aftësi të kufizuar, jo vetëm për ta pasur si kapitull, se ajo jo vetëm duhet të jetë e shkruar, por duhet të zbatohet patjetër. Ky shqetësim ka dalë edhe në aktivitetet që kemi zhvilluar dhe është shumë i drejtë. Reflektimi i parë do të jetë te pjesa e kodit. E përmendi më herët kryetarja, ne shikojmë përputhshmërinë, në qoftë se është e shkruar në ligj apo aktin nënligjor, pastaj kur është çështje e diskutueshme është gjë tjetër, por parashtrimet në aktet nënligjore dhe në ligj na vënë para një detyrimi, që ajo patjetër duhet të zbatohet. Duhet t'u tërheqim vëmendje subjekteve audiovizive që ta kenë parasysh dhe të zbatojnë ligjin për këtë çështje.

**Armela Krasniqi** – Doja t'i ktheja përgjigje pyetjes sa i takon ligjit për reklamën. Neni 62 i ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar, përcakton se asnjë zotërues i licencave kombëtare të transmetimeve audio dhe audiovizive, përfshirë OSHMA-të e licencuara për shërbimin e programit audioviziv dhe/ose të autorizuara për shërbimin e programit, të mbështetura në rrjete satelitore, nuk mund të transmetojë shumë se 30% të reklamave në tregun e transmetimeve audiovizive. Unë e përmenda edhe pak më parë, ne jemi shumë të vëmendshëm që masa 30% të mos kalojë nga asnjë OSHMA.

Unë ju ftoj të shikonin faqen zyrtare të AMA-s, ku janë publikuar të gjitha raportet e matjes sasiore të kohës së çdo OSHMA-je, sigurisht nuk mund të hy te vlerat, por do t'ju ftoja të shikoni se si AMA e ka pjesë të përditshme të punës së saj jo sot, por ndër vite monitorimin e kohës së reklamave dhe shpërndarjen e tyre po ashtu. Këtë na ngarkon ligji, të monitorojmë kohën e reklamave, as pjesën financiare dhe asgjë tjetër.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

AMA ka një server të saj të monitorimit të arshivës, i cili ruan përmbajtjet e zakonshme le të themi, 5 vjet, ndërsa përmbajtjet me rëndësi kombëtare jemi të detyruar t'i ruajmë deri në 10 vjet. Kështu që, ju mund të vini dhe të shikoni nëse analizat statistikore të drejtorisë përkatëse janë gabim. Deri në 30% e përcakton ligji dhe ne jemi shumë të vëmendshëm, unë i besoj stafit tim, në matjen e minutazhit të kësaj gjëje. Megjithatë, sigurisht, dyshimi është i

arsyeshëm, sepse televizionet kombëtare shihen më shumë, përqendrimi është më i madh tek ato. Unë me kënaqësi ju ftoj të vini ta vizioni AMA-n. Dyshimi është krejt i arsyeshëm dhe legjitim, pasi ne bombardohemi çdo ditë nga shumësia e reklamave në televizionet qendrore.

Sa i takon reklamës shtetërore, në fakt, ligji nr. 97/2013 përkufizon reklamat politike dhe institucionale, por në të nuk parashikohen rregulla dhe kritere për prokurimin e tyre, pra u është lënë një vendimmarrje autonome institucioneve nga dalin këto reklama, që kanë nevojë për të promovuar një pjesë të aktivitetit të tyre.

**Flutura Açka** - Kisha edhe unë një pyetje, meqenëse jemi te reklamat, por po ia jap fjalën zonjës Buxheli fillimisht.

**Lindita Buxheli** – Zotëria foli për kategorinë e fëmijëve me aftësi të kufizuara, në fakt, unë e kisha për kategorinë e fëmijëve me aftësi ndryshe, që është tjetër gjë.

**Armela Krasniqi** – Ndaj, zonjë, lind nevoja për ndryshimin e kodit të transmetimit, pasi nuk ekziston koncepti “fëmijë me aftësi ndryshe”. Lind nevoja edhe për një revolucion termash brenda këtij kodi. Ndërkohë, e kemi filluar punën për këtë.

**Flutura Açka** - Zonja Krasniqi, ne ju japim fjalën që si komision do të punojmë së bashku me ju, që të bëjmë më të mirën e mundshme e t’i përshtatemi legjislacionit, siç e ka gjithë Europa, që i ndihmon të gjitha kategoritë, pasi, në fakt, jemi shumë deficiente në këtë pikë.

Doja të shtoja edhe diçka tjetër, së shpejti do të vijmë t’ju vizitojmë dhe pastaj mund të flasim edhe më gjerë për shqetësimet tuaja.

Zonja Buxheli.

**Lindita Buxheli** – Faleminderit!

Unë e falënderoj edhe zonjën Bano për shqetësimin që ngriti për televizionin në qytetin e Lushnjës, pasi ishte një shqetësim mbarëqytetar. Ka rreth 7 -8 muaj që ka rifilluar nga puna normalisht e “TV 4 plus” pas një pauze disavjeçare.

Faleminderit!

**Flutura Açka** - Për balancë, jam e detyruar që fjalën t’ia jap zotit Ajazi.

**Besion Ajazi** – Faleminderit, kryetare!

Faktikisht, nuk doja t’i rikthehesha, por edhe të iki në qetësi, nuk mund ta lë për profesion, por edhe për ego personale. Më vjen keq, zonja kryetare, të nderuar kolegë, që shfrytëzohen komisionet për të bërë politikën e ditës për interesa personale apo për demagogji dhe nuk jemi fare seriozë kur bëjmë pyetje dhe largohemi. Është e disata herë që anëtarë të këtij komisioni, kolegët e opozitës, e bëjnë këtë...

**Flutura Açka** - Zoti Ajazi, në këtë rast është një arsye shumë e justifikuar!

**Besion Ajazi** – Nuk ka lidhje! E di arsyen, por është edhe një tjetër pas atij që largohet dhe nuk është e vetmja herë, por e disata. Unë e mirëkuptoj këtë rast, por nuk më pëlqen që shfrytëzohen hapësirat medietike për të bërë politikë dhe pastaj gjithsecili sheh punën e vet.

Këtu u fol për dhunën në media. Po, është e vërtetë dhe është problem edhe në Shqipëri, por nuk është një fenomen shqiptar, por botëror. E gjithë bota është në luftën ndërmjet televizioneve që shfaqin këtë dhunë dhe grupeve të interesit që e kundërshtojnë këtë gjë.

Gjithsesi, AMA, jo vetëm gjatë kësaj periudhe, por edhe gjatë viteve ka bërë punën e saj në këtë drejtim. U fol për dhunën ndaj gazetarëve, ndërkohë që e dimë shumë mirë se në çfarë periudhe ka qenë dhuna ndaj gazetarëve, madje ka pasur plumba në drejtim të gazetarëve. Kështu që, duhet të jemi edhe korrektë, edhe realistë, duhet ta vlerësojmë dhe të falënderojmë edhe një punë që bëhet. Patjetër që ka kritika, AMA nuk lulëzon dhe gjithçka shkon në rregull, po ne ndaj jemi këtu edhe si komision përgjegjës që edhe të sugjerojmë, edhe të bashkëpunojmë, edhe të orientojmë, pastaj të marrim vendimet së bashku me institucionet, konkretisht me AMA-n për ta bërë punën e saj më të mirë.

Kam tri pyetje faktikisht, por njëra u ezauroa nga raporti që lexoi kryetarja e AMA-s. Zonja Krasniqi, ju thatë se në zgjedhjet e fundit AMA pati një rol të shtuar, duke monitoruar pasqyrimin e procesit zgjedhor. A konstatuat problematika gjatë këtij procesi? Sa e përgatitur është AMA në vazhdimësi për monitorimin e pasqyrimin të zgjedhjeve, duke prodhuar të dhëna që do t'u shërbejnë proceseve zgjedhore të mëparshme, por edhe publikut?

Pyetja e dytë është pak jashtë periudhës së raportit, por është gjithashtu një problematikë aktuale, që lidhet me atë që prej dy muajsh po ndodh në Ukrainë, sulmin rus ndaj saj. Një vëmendje e madhe u është kushtuar problematikave që vijnë nga dezinformimi, apo siç quhet në gjuhën mediatike “fake news”. Do të doja të dija a keni pasur ju raste të konstatuara, ku është dashur ndërhyrja juaj dhe çfarë masash ka marrë AMA në këtë drejtim?

Faleminderit!

**Flutura Aça** - Faleminderit, zoti Ajazi!

Zonja Krasniqi.

**Armela Krasniqi** – Zoti Ajazi, ju faleminderit!

Sa u përket zgjedhjeve, siç e dini, unë gjatë periudhës zgjedhore isha në një institucion tjetër, por mund të them me shumë krenari që është një sfidë e kaluar me sukses nga Autoriteti, pasi për herë të parë në 21 vjet të veprimtarisë së tij ky autoritet u ngarkua nga ligji zgjedhor për të monitoruar mbulimin mediatik të OSHMA-ve në fushatën zgjedhore. Më parë ishte AMA, e cila vinte gjithë infrastrukturën në dispozicion dhe në KQZ ngrihej një institucion i posaçëm që bënte këtë lloj monitorimi.

Ne kemi qenë gazetarë dhe e mbajmë mend shumë mirë sa problematike kanë qenë ndër vite të gjitha raportet e bordit të monitorimit të ngritura pranë KQZ-së. Me aq informacion, shkresa dhe të gjitha gjetjet që kam arritur të lexoj dhe studioj në institucion, mund të them që vërtet është një sfidë, për të cilën AMA duhet të jetë krenare, pasi të gjitha gjetjet e zgjedhjeve të përgjithshme u përdorën nga monitorues vendas e ndërkombëtarë, por nuk pati asnjë kontestim sa o takon vetë OSHMA-ve, audio dhe audiovizivë, ku tregu nuk u ndie i sanksionuar gabim, apo i monitoruar gabim, nuk patëm raste, në të cilat AMA u gjet në faj, le të themi kështu.

Ndërkohë, nga ana tjetër, ajo çka kam vënë re vetë personalisht, duke qenë se vij nga fusha e medias, AMA është duke kryer vetëm një monitorim sasior, çka do të thotë mat kohën, pra ruan balancën kohore, siç e sanksionon ligji, por ajo që na mungon sot është monitorimi cilësor.

Gjatë kësaj periudhe disamujore në krye të Autoritetit, ndërsa kam folur me të gjithë kolegët në rajon, por kryesisht në Europë, mund të them se monitorimi cilësor është një pjesë e rëndësishme dhe e qenësishme e punës së tyre. Ne bëjmë monitorim cilësor si autoritet për sa u përket rasteve që gjykojmë se është shkelur e drejta apo është cenuar dinjiteti i njeriut në bazë të ankesave, por në fushatën zgjedhore monitorimi zgjedhor mund të them se mungon.

Për këtë çështje personalisht i jam drejtuar Këshillit të Europës dhe në bashkëpunim me ta, që prej muajit nëntor, kur e kam identifikuar se ishte diçka që pse jo, edhe ne duhet ta bëjmë si institucion, është ngritur grupi i punës, i cili do të asistojë Autoritetin me ekspertët më të mirë të Këshillit të Europës. Mund t'ju them se do të na asistojnë jo vetëm sa i takon teknologjisë apo *soft-it*, por edhe kriterëve që do të përmbajë ky monitorim cilësor, pasi fazën e parë të monitorimit sasior Autoriteti tashmë e ka kaluar. Duhet të shkojmë më tej për të parë edhe gjuhën e urrejtjes, fenomenet e seksizmit, edhe fenomene të tjera, të cilat shpeshherë na shqetësojnë edhe gjatë fushatës zgjedhore, por edhe jashtë saj. Kështu që, në këtë pikë, javën e ardhshme vijnë në Tiranë ekspertët e kontraktuar nga Këshilli Europian, të cilët do të na asistojnë edhe në këtë proces.

Nuk e di nëse AMA do të jetë gati për zgjedhjet pasardhëse vendore, por shpresoj fort që kjo teknologji dhe *soft-et*, si dhe kriteret përkatëse të bëhen sa më parë që të jetë e mundur, pasi vërtet do t'i shërbejnë shoqërisë shqiptare dhe ngritjes së zërit për këto lloj fenomenesh.

Pyetja tjetër kishte të bënte me ngjarjet në Ukrainë. Në fakt, edhe zonja kryetare ka qenë pjesë e tërheqjes së vëmendjes së AMA-s për çështjen e dezinformimit. AMA, në fakt, funksionon në bazë të ankesave, por edhe në bazë të monitorimit që bëjnë vetë inspektorët e saj në zyra dhe nuk ka qenë një rast, por kanë qenë dy raste flagrante, të cilat ishin vërtetë



dezinformim, por përtej kësaj, glorifikonin presidentin aktual, e quanin luftën të paqenë, fëmijët e vrarë të paqenë (nuk dua të amplifikoj se çfarë është thënë në këto OSHMA) dhe AMA ndërhyri intensivisht. Mund të them se kemi pasur një debat goxha të shtuar me OSHMA-të përkatëse, një debat i cili nga ana e OSHMA-ve u duk i padrejtë, sikur ne po cenonim lirinë e tyre të shprehjes, në fakt, është krejt e kundërta, ne absolutisht që nuk mund të cenojmë lirinë e shprehjes, por jemi duke mbrojtur vlerat themelore për të cilat kemi rënë dakord të gjithë bashkë. Në këtë pikë, në momentin e parë OSHMA-ve iu duk si një goditje personale, por mund të them me bindje që OSHMA-të tashmë kanë reflektuar të gjitha dhe nuk kemi më fenomenet që ndodhën, sidomos në momentet e para, pas shpërthimit të luftës atje.

Do t'ju thosha që, për sa i përket qëndrimit tonë, duke qenë se gjendemi për herë të parë në një situatë të tillë, jo vetëm ne, por edhe shumë vende të BE-së, personalisht kam ndjekur me shumë vëmendje të gjitha seancat e debatit dhe qëndrimet që u mbajtën në ERGA, që janë 27 rregullatorët europianë, të cilët dolën me dy vendime radhazi, pasi edhe ne apo vende të tjera u gjendëm në vështirësi, që nuk kishim të licencuara kanale si “Russia Today”, por vendet e tjera të BE-së kishin problematika të tilla. Duke ndjekur me shumë vëmendje vendimet e ERGA-s dhe të Komisionit Europian, si dhe aktet nënligjore që nxori Komisioni Europian, ne vepruam dhe e mbështetëm veprimtarinë tonë në bazë të këtyre vendimeve, pavarësisht se ne jemi thjesht vëzhgues në këto organizma.

Faleminderit!

**Flutura Açka** - Faleminderit, zonja Krasniqi!

Zonjusha Ulliri, ka pyetje.

**Andia Ulliri** – Faleminderit, kryetare!

Së pari, do të doja të sillja në vëmendjen tuaj se, sipas raportit “Reporterët pa kufij” të vitit 2021, ku ju tregoni se Shqipëria ka pasur një rezultat në rritje, duke u përmirësuar me 1 pikë, ndërkohë i njëjti raport në vitin 2022 tregon se Shqipëria është ulur 20 vende, ndërsa vendet e rajonit janë ngritur në pozicionet e tyre dhe Shqipëria është e fundit në rajon. Kjo është për sa i përket medias së lirë. Sipas raportit, gjithashtu, Shqipëria bën pjesë në listën e shteteve, ku autoritetet kanë intensifikuar ligjet kundër gazetarëve. Pyetja ime është: si do ta cilësoni këtë fakt mbi përgjegjësinë që institucioni juaj ushtron mbi mbrojtjen e një medie të lirë?

Duke ardhur me një raport ku thuhet se është përmirësuar me 1 pikë, ndërkohë që situata flet krejt ndryshe, do të thotë që diçka nuk po shkon mirë, edhe ju si autoritet rregullator duhej të kishit pasur hapa ku ju keni dështuar.

A keni një analizë ku ju dëshmoni se cilët janë hapat që keni ndërmarrë, të cilët kanë sjellë në këtë pikë dështimi, ku sot Shqipëria nuk bie 1 apo 2 pozicione, por 20 pozicione, të cilat cenojnë një medie të lirë, cenojnë të drejtat e çdo gazetari, të drejtat e çdo individi që operon në fushën e medias e më tej në Shqipëri?

Së dyti, një shqetësim që doja të ngrija, që është diskutuar shpesh në Komisionin e Edukimit, është fakti që gjuha shqipe dita-ditës po humb identitetin e saj. Pavarësisht se është përmendur shumë herë këtu, por duhet risjell në vëmendje fakti që gjatë praktikave tona si parlamentarë, si ushtrues të ligjit, shohim shpesh nga mediet artikuj, jo vetëm *fake news*, siç e cilësoi deputeti Ajazi, por edhe artikuj me problematika gramatikore e të tjera. Dua të di se çfarë është bërë për përmirësimin e këtij problemi. Çfarë hapash keni ndërmarrë deri më sot dhe reagimi juaj mbi një çështje që cenon identitetin tonë shqiptar?

Gjithashtu, pati diskutime mediet lokale. Në raportimin tuaj ju keni treguar që keni pasur rekomandime në proces. Një nga rekomandimet tuaja në proces thotë që në fund të qershorit 2022 do të fillojë puna me rishikimin e tarifave për t'i dhënë një zgjidhje problemit të tarifave të mbështetjes së rrjetit numerik të RTSH-së nga operatorët lokalë, gjë që edhe deputetja Bano e dëshmoi, se është një problem për mediet lokale, për operatorët lokalë, të cilët paguajnë tarifa shumë të larta dhe nuk marrin asnjë mbështetje vetë si operatorë lokalë, ku operojnë në kushte jo të favorshme, në krahasim me operatorët kryesorë, që gjenden në shumicën e rasteve në qytetet kryesore, si Tirana.

Sa paguajnë aktualisht këta operatorë dhe, nëse është e mundur, sa është parashikuar të jetë reduktimi në përqindje për operatorët lokalë, nëse ju keni parashikuar të tillë zgjidhje, duke qenë se është pjesë e raportit dhe e rekomandimeve në proces?

Një pyetje tjetër ose një sqarim për çfarë do të thoshte deputetja, së cilës iu desh të largohej, ishte për komunitetin me nevoja të veçanta shqisore.

Pavarësisht se ajo ndodhet këtu, pyetja e saj ishte për këtë komunitet. Ju dhe ne e dimë se gjuha e shenjave është një çështje me rëndësi dhe me impakt. Impakti i saj është jo i vogël në komunitetin me nevoja të veçanta shqisore.

Kosova ka bërë një përmirësim të dukshëm në këtë aspekt dhe Shqipëria akoma edhe në vitin 2022 është mbrapa në këtë proces dhe e shoh se ka probleme me personat që janë specialistë të kësaj fushe, të cilët duhet të jenë integruar.

Cilët janë hapat që merren parasysh dhe si do të zgjidhet një detyrim ligjor që garanton të drejtën e informimit në një komunitet kaq të gjerë.

Unë mendoj, bashkë me kolegët e opozitë në Komisionin e Edukimit, se kjo është një çështje me shumë rëndësi dhe është një shqetësim që duhet të ketë më shumë zë, jo vetëm në këto komisione, por edhe në tryeza të tjera.

Shoh se ka pasur disa procese gjyqësor, por këtu thuhet se disa nga këto procese janë pushuar ose janë humbur dhe disa janë fituar, pra për çështje të cilat impaktojnë edhe vetë AMA-n. Ju keni qenë të përfshirë në 26 procese gjyqësore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë në Tiranë.

Ju këtu thoni se duhet të ketë një analizë. A keni fakte për çështje, të cilat i keni humbur në gjykatë?

Kam diçka për pikën 6 të këtij raporti. Këtu tregohet se ka dështuar dy herë procedura e tenderimit të hapur në korrik dhe tetor 2021 për implentimin e programit “*Help desk*”, për të cilin është rihapur procedura në vitin 2021. Dua të di për transparencë se cila ka qenë arsyeja e dështimit të dy procedurave të para dhe cili nga operatorët fitues është shpallur fitues? Çfarë synon konkretisht “*Help desk*”?

Do të doja të vija disa pika mbi “i” për çështjen e mbrojtjes së statusit të gazetarëve. Ky komision ka qenë pjesë e raportimit nga Komiteti i Helsinkit, ku është trajtuar çështja e të drejtave të gazetarëve dhe se si mbrojtja e statusit të tyre duhet të ketë një vëmendje më të gjerë dhe sigurisht nga autoriteti kryesor, i cili është autoriteti rregullator i AMA-s, përveç autoriteteve të tjera ligjore.

Unë vetë kam dëshmuar një dizavantazh në statusin e këtyre gazetarëve, në statusin e këtyre njerëzve, të cilët duan të përçojnë sa më parë lajme të sakta dhe raportime nga vendet konkrete ku ata zakonisht ballafaqohen me shumë problematika, vështirësi, vështirësi në terren dhe, meqë u prek edhe çështja e dhunës, pak ditë më parë kam qenë vetë pjesë e protestës në Rinas kundrejt një çështjeje e cila ishte e pamenduar dhe impaktoi një komunitet shumë të gjerë, ku pati edhe shfaqje të dhunës policore. Kur një deputet ndodhet përballë dhunës policore dhe nuk ka asnjë mbrojtje nga kjo dhunë, për vetë faktin se jemi të mbrojtur me ligj si deputetë, dua të di se si mund të mbrohet një gazetar i thjeshtë kur statusi i tij është i cenuar dita-ditës? Pra, në momentin që autoritetet policore ndërmarrin masa kritike dhe tregojnë dhunë policore edhe ndaj personave që veshin një xhakëtë si deputetë, të mandatuar nga populli, si mund të mbrohen interesat, ose si mund të mbrohet siguria e një personi, i cili nuk gëzon këtë mbrojtje?

Këto ishin disa pyetje në parashtrimin tim të parë. Pres përgjigjen tuaj.

Faleminderit!

**Flutura Açka** – Faleminderit!

Urdhëroni, zonja Krasniqi!

**Armela Krasniqi** – Pa dashur të biem në ripërsëritje për sa i përket raportit të “Reporterëve pa kufij”, raporti thotë se kanë ndryshuar ligjet dhe ka ligje kundër gazetarëve, por, në dijeninë time, unë nuk di të jetë miratuar ndonjë ligj kundër gazetarëve. Ndoshta, “Reporterët pa kufij” i referohen ligjit kundër shpifjes, i cili, me sa di, ende nuk është miratuar, kështu që unë nuk për çfarë ligji kundër gazetarëve bëhet fjalë.

Në dijeninë time, nuk ka ligje të reja, të paktën, në institucionin që unë drejtoj ne funksionojmë me një ligj të miratuar që nga viti 2013, ligji nr. 97.

Për sa i përket gjuhës shqipe, unë ju falënderoj shumë për pyetjen tuaj, pasi e vlerësoj tejet, tejet të rëndësishëm standardin e gjuhës shqipe, i cili është vërtet ashtu siç ju thatë, i bashkohem zërit tuaj që ka shumë gazetarë të cilët e cenojnë gjuhën shqipe. Por, duhet pasur parasysh se AMA vepron vetëm sa u takon radiove dhe televizioneve, ndërsa gazetatat, portalet, mediet sociale në rrjet nuk janë në fushën e kompetencave të autoritetit.

Po ashtu, mund të them që edhe në televizione ka plot raste kur standardi i shqipes shkelet. Për këtë arsye, nga vetë autoriteti, duke ndjerë këtë nevojë, këtë problematikë që shumë herë është bërtitëse, sidomos në televizionet informative, të cilat janë në nxitimin dhe në presionin e kohës, ne vëmë re fenomene të kësaj natyre.

Për këtë arsye AMA ka mbështetur projekte ndër vite, të cilat i kanë vajtur më pranë gazetarëve. Kjo ka qenë një punë e vijueshme e AMA-s për të ruajtur standardin e gjuhës shqipe.

A duhet bërë më shumë? Jam dakord me ju që duhet bërë më shumë dhe ndoshta bashkë me drejtuesit e institucionit që janë këtu, me stafin, nëse edhe ju do ta lini si rekomandim në rezolutën e Kuvendit, patjetër do të jemi akoma më shumë të fokusuar në këtë drejtim. Unë bashkohem me shqetësimin tuaj dhe e ndaj si shqetësim.

**Andia Ulliri** – Një sqarim për pyetjen e parë, ishte jo vetëm dëshmimi i faktit që ne kemi rënë 20 vende, por cilat janë arsyet pse ne kemi rënë 20 vende. Cilat janë hapat që keni ndërmarrë, që ju i cilësoni se keni dështuar?

Raporti i “Reporterëve pa kufij” cilëson se Kryeministri i Shqipërisë nuk ka marrë ende përsipër të ndryshojë apo të tërheqë një paketë drakoniane, antishpifje, që është ende pezull në parlament, dhe vazhdon të rrijë si shpata e Demokleut mbi kokat e gazetarëve të vendit dhe “Reporterët pa kufij” u kërkojnë institucioneve europiane të kërkojnë garanci të qarta që Shqipëria të jetë në përputhje me dëshirën e saj për t’u anëtarësuar në BE.

Pra, autoritetet kanë intensifikuar ligjet kundër gazetarëve. Kjo ishte për sqarim të parashtrimit tuaj.

Vetëm për t’iu rikthyer pyetjes, duam të dimë pse kemi rënë 20 vende.

Faleminderit!

**Arben Muka** – Vlerësimi i “Reporterëve pa kufij”, materiali i tyre, sigurisht që jemi njohur ne, është njohur edhe publiku, ka një vlerësim për tregun medietik në Shqipëri, për gjithë dinamikën. Për sa i takon sektorit në të cilin AMA është rregullatori dhe për frikën që ju thatë s’ma do mendja se gazetarët audio dhe audiovizivë kanë frikë se media *online* do të ketë rregulla të reja. Domethënë, për sa i përket shqetësimit tuaj, është e shkruar e zeza mbi të bardhë ajo që ju cituat, por të mos harrojmë se tregu në tërësi, problematikat që ka tregu në tërësi dhe ato që ka tregu audio dhe audioviziv, unë dhe kryetarja, kolegët e mi, jemi sot këtu për t’i folur.

Sigurisht, ajo që përmendi më herët kryetarja, ne kemi shumë elemente, siç ishte kodi i transmetimit, ndryshimi i akteve nënligjore, por ne jemi ligjzbatuese, ne nuk jemi OJF, nuk jemi agjenci. Ne na detyron ligji të jemi gardianë të tij dhe ne aty shikojmë nevojën për ndryshime. Ajo që është përmendi edhe kryetarja, përmirësimi i cilësisë në raportim është shumë i rëndësishëm. Për mendimin tonë, është liri për gazetarët dhe për konsumatorin, tek ai ku do të shkojë produkti, qoftë audioviziv, qoftë *online*. Prandaj po them se ne e shikojmë në aspektin e fokusit që na ka lënë ligjvënësi. Kuvendi i Shqipërisë na ka bërë në vitin 2013 këtë ligj që do të jemi në sektorin audio dhe audioviziv. Nëse ka një ligj tjetër, se ju përmendët një citim aty, që është një lloj kërcënimi, i takon një fushe që nuk është fare në juridiksionin e AMA-s. Në qoftë ato janë të kërcënuar si portale që, po u fut ky ligj, do të cenohet liria e fjalës, ne mendojmë se është jashtë kontekstit të angazhimit tonë.

Ajo që ju përmendët është për tregun *online* në tërësi, i cili është një proces i gjatë që ka vite që ka filluar që para pandemisë, pra është menduar ky ndryshim i ligjit të futet dhe të rregullohet media *online*. Por sot nuk jemi në ato pozita, AMA është jashtë kësaj.

**Armela Krasniqi** – Është e pamundur që ne t’i kapërcejmë kompetencat e ligjit, pavarësisht se diçka mund ta kuptojmë se është gabim, si profesionistë të fushës, por jemi të detyruar të rrimë brenda normës që na përcakton ligji nr. 97/2013 dhe ligji është shumë i qartë, po ashtu edhe aktet nënligjore që kanë pasur atë.

**Andia Ulliri** – Nëse ju përket ju si çështje ligjore, cili është reagimi juaj mbi këtë çështje? Si e cilësoni ju si AMA këtë humbje të pozicionit tonë? Nëse ne patëm një fitim me një pikë dhe është cilësuar këtu, ndërsa kjo me 20 vende nuk është cilësuar, ndoshta për arsye të datës kur është dorëzuar raporti, dua të di a ka AMA ndonjë reagim për këtë?

**Armela Krasniqi** – Siç e thoni edhe ju vetë, raporte të ndryshme kanë vlerësime të ndryshme, njëri na rrit me një pikë, një tjetër na ul me 20 pikë. Sigurisht që ka probleme në Shqipëri, por ne jemi të detyruar të zbatojmë vetëm kuadrin ligjor që kemi si bazë dhe themel të punës sonë.

Unë për shkak edhe të përvojës së punës, për shkak të dëshirës dhe interesit, i lexoj të gjitha studimet që janë bërë dhe mund të them se mosha 18-40 sot, 60% e saj, informohet përmes portaleve, informohet nga interneti, nuk informohet më nga mediet tradicionale, pra nga ajo sferë e veprimtarisë ku ne jemi. Pra, ne e kemi fushën e veprimtarisë së institucionit të përcaktuar dhe nuk mund të mbajmë mbi supë të gjithën. Patjetër, AMA ka ndërhyrë. Unë ju kujtoj rastin e fundit të gazetares së një emisioni investigativ, ku gazetarja u dhunua verbalisht dhe AMA ka ndërhyrë me instrumentet e saj, fjalën, sepse në këtë rast ne nuk kemi asnjë instrument ligjor që mund të jemi sanksionues. Janë institucionet të tjera ligjzbatuese ato që venë sanksione mbi atë që ushtron dhunë, qoftë edhe verbale me një gazetar, por, patjetër, kur ka pasur raste të tilla, ne kemi ndërhyrë aktivisht, duke u bërë pjesë e debatit publik për këtë gjë.

Është shumë i rëndësishëm shqetësimi që ju ngritët për sa i përket gjuhës së shenjave. Unë bashkëndaj me ju këtë shqetësim. E kam gjetur si shqetësim në institucion. Mund të them që është vetëm televizioni publik, RTSH-ja, i cili ka një emision lajmesh të dedikuar me gjuhën e shenjave, ndërkohë OSHMA-të e tjera kombëtare, të cilat kanë detyrimin për të pasur një interpret të gjuhës së shenjave, në fakt, duke qenë se gjithmonë ne u kemi tërhequr vëmendjen se nuk po zbatoni këtë kusht të licencës, ata na kanë kthyer përgjigjet e tyre dhe nga ana e tyre ka qenë e pamundur, sepse, me sa kuptojmë, ka një mangësi në treg të interpretëve të gjuhës së shenjave, çka do të thotë se kemi një problem te procesi arsimor, sepse nuk po dalin më breza të rinj, interpretë të gjuhës së shenjave.

Për këtë çështje ne tashmë kemi një komunikim të vijueshëm për të gjetur një zgjidhje të këtij fenomeni në bashkëpunim, jo vetëm me Ministrinë e Arsimit, por edhe me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Pra, ky është shqetësim që e bashkëndajmë të tria institucionet dhe besoj se do të gjejmë një zgjidhje shumë shpejt, por, me sa kuptoj, është problemi se nuk regjistrohet njeri që të arsimohet për të qenë interpret i gjuhës së shenjave.

**Flutura Açka** – Jo, tek ato shenja nuk shkojmë dot ne, por ne as te gjuha shqipe nuk shkojmë dot, kur na janë mbyllur disa degë. Sot nuk kemi në Elbasan asnjë student të gjuhës shqipe. Jemi keq, jemi katastrofë!

**Sara Xhumbari** – Në lidhje me tarifat financiare dhe mbështetjen që u ofrohet operatorëve lokalë, siç e tha edhe kryetarja, digjitalizimi ishte në proces ndryshimi rrënjësor për sa u përket transmetimeve televizive, proces, i cili u finalizua në dhjetor të vitit 2020. Përveç akteve ligjore, është miratuar edhe ligji për kompensimin financiar, i cili është duke implementuar nga AMA. Ligji parashikon një ndihmë për operatorët lokalë, të cilët janë mbështetur për shkak të procesit të digjitalizimit në njërën prej rrjeteve, ku mbartin shërbimin

e tyre programor. Ky ligj vijon të zbatohet nga ana e AMA-s, kuptohet me përmbushjen e një sërë kriteresh nga ana e operatorëve. Në vitin 2021 ka pasur një vendimmarrje të re të AMA-s, në lidhje me zgjatjen e kohës së mbulimit të kompensimit, diku nga maji 2021, ku u zgjat periudha e mbështetjes mbi 8 muaj kompensim.

Ndërsa për sa u përket tarifave që aplikohen aktualisht, në fakt, tarifat janë të ndryshueshme në varësi të zonës së ofrimit të mbulimit. Për shembull, qarku i Kukësit e ka 400 euro tarifën e mbështetjes, qarku i Fierit e ka rreth 1600 euro, qarku i Tiranës, duke qenë se është edhe qarku kryesor, ka një vlerë më të lartë. Pra, tarifat janë të ndryshueshme në varësi të zonës së mbulimit dhe në varësi të zhvillimit dhe situatës së çdo qarku.

Për sa i përket rishikimit të tyre, në fakt, rishikimi i tarifave është një proces, i cili është duke u ndjekur nga ana e AMA-s. Ligji parashikon që tarifat e mbështetjes, propozohen nga RTSH-ja, pra ka një sërë parimesh të parashikuara në ligj, që është parimi i objektivitetit, transparencës, mosdiskriminimit, pra janë parime, të cilat duhet të mbahen parasysh nga ana e operatorit publik gjatë hartimit të tarifave. Këto tarifa vijnë në AMA dhe miratohen nga ana e AMA-s.

Procesi i rishikimit në këtë moment është duke u ndjekur, por jemi në pritje të përfundimit të procesit të DV2-it, sepse janë procese, të cilat janë të lidhura me njëra-tjetrën. Për shkak të lirimit të DV2-it, mund të ketë ndryshime në rrjetin e transmetimit dhe në zonat e ofrimit shërbimit të subjekteve të licencuara aktualisht për shërbim lokal, pra jemi në fazën e rishikimit. AMA është në fazën e rishikimit dhe e ka ndër objektivat e saj rishikimin e tarifave të mbështetjes së operatorëve lokal.

**Andia Ulliri** – Në pyetje u cilësua edhe për operatorët lokalë, pavarësisht se e kuptoj të gjithë kontekstin e parashtrimit tuaj. Dua të di nëse ju e keni parashikuar se sa për qind do të ketë reduktim. Pra, duke marrë një sërë faktorësh parasysh, sa mund të jetë përqindja?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Sara Xhumbari** – Nuk mund të dalim me vlera fikse se sa parashikohet ulja apo nëse eventualisht mund të ketë edhe rritje, sepse tarifat propozohen nga operatori publik. Tarifat që janë duke u zbatuar nga ana e operatorit publik, janë tarifa të përkohshme, pra do të pësojnë ndryshime. Ndërsa për sa u përket tarifave, që aplikon AMA në lidhje me licencat që lëshon, këto janë objekt rishikimi. Edhe në strategjinë dhe në planin e veprimit të AMA-s për periudhën 2021-2023 është i përfshirë procesi i rishikimit të tarifave dhe këtu ka disa parime, të cilat mbahen parasysh nga ana jonë gjatë përgatitjes së procesit të rishikimit të tarifave, duke shkuar në kufirin që tarifat të jenë deri në mbulimin e kostove administrative të autoritetit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Pyetja tjetër kishte të bënte me proceset gjyqësore. Në proceset gjyqësore të zhvilluara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, të paktën për vitin 2021 AMA, ka qenë e përfshirë në 25 procese administrative, ndër këto procese kemi parasysh se AMA nuk ka qenë vetëm palë e paditur, por ka qenë edhe AMA, e cila vetë në cilësinë e personit juridik ka investuar organet gjyqësore, me qëllim mbledhjen e detyrimeve financiare, kryesisht proceset gjyqësore kanë të bëjnë me mbledhjen e detyrimeve financiare që operatorët, të cilëve u është hequr ose u është bërë e pavlefshme licenca, kanë kundrejt AMA-s. Janë procese që në 99% të rasteve janë të fituara nga ana jonë. Ndërsa për sa u përket proceseve administrative, ku AMA ka qenë palë e paditur, kryesisht proceset gjyqësore lidhen me sanksionet gjobë. Pra, pjesa dërmuese e padive lidhen me sanksione administrative në formë gjobe të marra nga ana e AMA-s, por edhe vendimmarrje të tjera, kryesisht për heqjen e licencave ose të autorizimeve. Unë mund të them se gjykimi në gjykatat administrative ka ndikuar pozitivisht, qoftë në afatin e përfundimit të proceseve, qoftë edhe në mënyrën se i ka qenë vendimmarrja e gjykatës, pasi ka rezultuar që AMA ka shumë vendime në favor të saj. Ndërkohë, ka një listë të gjatë të proceseve gjyqësore, e cila është pjesa e aneksit të bashkëlidhur, por janë procese gjyqësore, të cilat janë në zhvillim pranë gjykatave administrative të apelit apo në Gjykatën e Lartë, janë procese të mbartura prej vitesh, madje mund të them se ka çështje në lidhje me vendimmarrje të AMA-s të vitit 2013 apo të vitit 2012, të cilat, për shkak të ngjeshjes së dosjeve, përsëri kanë ngelur pa një vendimmarrje përfundimtare nga ana e gjykatave.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Një nga pyetjet tuaja kishte të bënte me analizën e vendimeve gjyqësore.

Në fakt, gjykatat janë të pavarura dhe marrin vendime, përveç provave, fakteve dhe debateve gjyqësore, edhe në bazë të një bindjeje të brendshme. Për shembull, mund të them se pranë gjykatave administrative, të paktën të shkallës së parë, ku zhvillohet edhe debati gjyqësor për të njëjtën çështje, me të njëjtat palë dhe me të njëjtin objekt ka dy vendime, të cilat ndryshojnë të tërësisht, njëri mund të jetë pranim dhe tjetri rrëzim. Gjithsesi, në të gjitha vendimet e arsyetuara të ardhura në autoritetet merren parasysh dhe nënvizohet çdo mangësi, qoftë procedurale, qoftë materiale, pra mbahet parasysh në praktikën vijuese, në mënyrë që të mos përsëriten, të paktën ato që nga gjykata janë evidentuar si cenim apo shkelje të legjisllacionit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Flutura Açka** – Zonja Ulliri, ju lutem, vetëm me mikrofon që të regjistrohet gjithçka!

**Andia Ulliri** – Në lidhje me analizën që ju folët, ku thatë se mbani shënime për të mos u përsëritur, cili mund të jetë një rast?



**Sara Xhumbari** – Ato janë praktika të brendshme.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Kjo është në rrafshin e përditshëm administrativ.

**Armela Krasniqi** – Ato janë çështje procedurash, megjithatë mund t’ju them se të gjitha rastet që Gjykata e Shkallës së Parë na i rrëzon, ne insistojmë dhe vijojmë fort që t’i fitojmë fort në Gjykatën e Apelit. Çdo çështje, që ne na është rrëzuar, ka shkuar në Gjykatën e Apelit, pra është ankimuar.

Për sa i përket “*help desk*”, është një procedurë prokurimi; drejtoresha e Financës më thotë blerje të vogla, por është një rekomandim i Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili është lënë për administratën pas procesit të digjitalizimit, në bazë të rekomandimit të Kuvendit të Shqipërisë. AMA gjatë 1 viti kontraktoi disa punonjës për të mbajtur sistemin operativ të ankimit. Pra, nuk kam sinjal televiziv këtu, kam probleme me sinjalin, nuk më vjen filan kanal, ankesa të kësaj natyre, të cilat përpunoheshin nga një sekretari telefonike me individë, por ky projekt do të zgjaste vetëm gjatë 1 viti dhe pas kësaj periudhe kohore ishte menduar që të kishte burime njerëzore për ta përballuar fluksin, pasi sapo ishte bërë procesi i digjitalizimit dhe, sigurisht, ankesat ishin të pafundme, sepse kishte ndryshuar komplet qasja e njerëzve drejt televizionit, në një moment të dytë është lënë rekomandimi që këtë funksion ta kryejë një sistem i automatizuar. Ky është “*help desk*”, që do t’u shërbejë të gjitha sistemeve, IT-së, raportimeve brenda institucionit, ku ka pasur një vlerë 700 mijë lekë, në mos gaboj, nuk jam e saktë.

Pse është rrezuar?! Në fakt, pjesën e procedurave të prokurimit, me sa më ka informuar stafi, thjesht oferte jo të vlefshme, procedura, pra thjesht vlera ka qene jo e mjaftueshme për operatorët. Nuk di ta them, por, le të themi, për oferta jo të vlefshme.

**Flutura Açka** – Faleminderit, zonja Krasniqi!

Faleminderit, zonja Xhumbari!

Zonja Bakiu ka pyetje.

**Merita Bakiu** – Faleminderit, zonja kryetare!

Do të mundohem të jem sa më selektive, sepse shumica e pyetjeve këtu u ezauruan. AMA dhe RTSH-ja janë dy institucione, të cilat financohen nga buxheti i shtetit dhe legjislatori i ka trajtuar me të njëjtën peshë për nga rëndësia që kanë, duke i bashkuar në një ligj të dyja, sepse janë dy institucione që administrojnë asete publike.

Pyetja ime: si është cilësia e programeve televizive dhe radiove që ajo licencon? Ne shikojmë sot se mediat cenojnë dinjitetin e shtetasve dhe flasin për etikën, që është një problem kryesor për mediat. A ka filtër që kontrollon paraprakisht apo gjatë transmetimit, etikën dhe cilësinë e programeve audiovizive? Sot ka një problematikë mes AMA-s dhe RTSH-së, me

arrestimin e ish-drejtorit Gëllçi, ku akoma vazhdojnë hetimet, i cili është akuzuar për shpërdorim tenderësh, janë mbyllur disa nga kanalet televizive, me pretendimin se mbaronte kontrata me AMA-n. Pyetja ime është e tillë: kush përfiton nga shkurtimi i këtyre kanaleve të RTSH-së?

Gjithashtu, një prej këtyre kanaleve, që po mbyllet, është kanali “Agro”, i cili është hapur në funksion të Ministrisë së Bujqësisë dhe institucioneve të tjera në varësi që ka kjo ministri. Atëherë, pyetja është e tillë: si mund ta ndihmojmë dhe ta mbështesim RTSH-në për t’i realizuar sa më mirë detyrimet kundrejt publikut?

Ju folët për të drejtat e fëmijëve, meqenëse deklaruat se AMA merret me të drejtat e fëmijëve, a keni bërë fushatë sensibilizuese në arsimin parauniversitar dhe atë universitar për këtë problem?

Sot që ne po flasim, drejtori i Radiotelevizionit Shqiptar ka shkarkuar nga puna 7 redaktorë. Në të njëjtën kohë që Këshilli nuk është mbledhur dhe kanë kontestuar mbylljen e këtyre kanaleve. Ju lutem, si mendoni për shkarkimet që janë bërë sot?

Faleminderit!

**Flutura Açka** – Urdhëroni, zonja Krasniqi!

**Armela Krasniqi** – Faleminderit për pyetjet dhe për shqetësimet që ngritët!

Dua të them se, po, është e vërtetë që AMA zotëron pasuri kombëtare. Ato janë frekuencat numerike tokësore dhe satelitore. Në fakt, mënyra e financimit të AMA-s është krejt e kundërt nga çdo institucion tjetër. AMA është me vetëfinancim. Domethënë, të gjitha të ardhurat, që ne mbledhim nga *fee-t* që paguajnë OSHMA-të, pagesat audio dhe audiovizive, pra ne mbahemi vetëm në bazë të këtyre kontributeve, pra ne nuk kemi peshë në buxhetin e shtetit si institucion.

Për sa i përket filtrit që ju thoni për programet televizive, dua t’ju kujtoj se ligji nuk i jep kaq shumë dorë autoritetit të veprorë. Ligji nuk e përcakton autoritetin si kryeredaktor apo drejtor programi në asnjë institucion privat mediatik, përkundrazi, ligji na detyron vetëm pjesën e ruajtjes së normave etike që përmbahen në kodin e transmetimit dhe në çfarë është shkruar në ligjin nr. 97/2013, por, nga ana tjetër, AMA, në bashkëpunim me OSHMA-të, ka ngritur bordet e etikës, të cilat, realisht, siç ju e ngrini me të drejtë shqetësimin, janë një filtër paraprak. Sigurisht, herë pas here, ka shqetësime, ka ankesa nga individë, nga shoqatat dhe nga grupe interesi dhe AMA menjëherë u drejtohet këtyre bordeve të etikës, të cilat janë ngritur dhe funksionojnë si rrugë komunikuese me këshillin tonë të ankesave. Për çdo ankimim, që bëhet në AMA, veprimi është i menjëhershëm, por edhe në raste kur vetë ne ose pjesë të stafit shikojmë diçka që nuk është në përputhje me kodin, menjëherë reagojmë në gjuhën gjyqësore,

kryesisht ndonjë gjetje të vetë monitoruesve tanë. Ndërsa për sa u përket programeve, unë e përmenda edhe pak më herët, ndoshta zgajtem pak shumë, por absolutisht është kënaqësi të flasësh para jush dhe të raportosh, pasi vërtet disa gjëra duhen thënë, dhe ju thashë edhe më herët që me RTSH-në ne jemi ende në fazën pritëse. Domethënë, kontrata 5-vjeçare me AMA-n ka mbaruar dhe është e vërtetë ajo që thuhet në atë që lexuat ju, por RTSH ja ende nuk ka ardhur me buqetë programore të re pranë nesh dhe ne flasim vetëm pasi na dorëzon letrat dhe është në autoritetin e vetë institucionit të vendosë se si do ta menaxhojë paranë publike që merr. Nuk jemi ne institucioni që e rregullon këtë. A mund të jetë ligjvënësi, pra mund të jeni ju, apo Komisioni i Ekonomisë dhe Financave, nuk e di, por jo institucioni i autoritetit. Pra, ne nuk ndërhyjmë te RTSH-ja për pjesën buxhetore. Sigurisht, ne ndërhyjmë te RTSH-ja për të gjitha ato nene që na i ngarkon ligji për sa u përket minoriteteve dhe çështjeve të kësaj natyre që, patjetër, duhet të jenë të reflektuara në programet që licencen AMA. Unë mund t'ju them se puna me RTSH-në ende nuk ka nisur dhe shumë shpejt do të nisë. Patjetër, ato janë në autonominë e tyre të vendosin nëse duan që në platformën e tyre të kenë 14, 21 apo 10 kanale. Këtë nuk e përcaktojmë dot ne se si do të jenë këto kanale, njëlloj përmbajtje një lloj draftimi përmbajtjesor për kanalet, duke iu referuar kushteve dhe kriterëve të ligjit, patjetër ne do t'ia kërkojmë RTSH-së.

**Arben Muka** – Nëse do të keni parasysh te prodhimet e pavarura, prodhimet e pavarura janë një element shumë i rëndësishëm i RTSH-së, sepse nxisin pluralitetin, pra janë individë, grupime, krijues jashtë RTSH-së që bëjnë produkte. Aty thuhet që ata i dorëzojnë AMA-s çdo një vit një raport si e kanë shfrytëzuar këtë. Sigurisht ne nuk mund t'i orientojmë dhe t'u themi: çojini prodhimet e pavarura të jenë për këtë fushë apo për këtë. Ata raportojnë te ne, sepse e nxisim që duhet ta shfrytëzojë, sepse për 3 vjet nuk e ka shfrytëzuar. Dy vjetët fundit po e shfrytëzon. Pra, ju keni të drejtë kur thoni çfarë bën AMA, sepse ligji thotë që në rastin e prodhimit të pavarur, ata e raportojnë te ne. E bëjnë, por linjën editoriale, sepse e përmendi kryetarja, katalogun e programeve ata e kanë vetë. Përputhshmërinë ligjore, sigurisht, e kemi ne, kur shikojmë kontratën dhe themi përputhshmërinë ligjore dhe u themi: më falni, por ju mungon ky zë kanali, sepse duhet t'i përfaqësosh të gjithë, se je transmetues publik, të gjitha shtresimet sociale. Vërtet ne kemi rolin se i shikojmë, por pjesa e ndërhyrjes duhet parë, sepse ata kanë autonominë, bordi i tyre, Këshilli Drejtues zgjidhet nga parlamenti. Të nderuara zonja dhe zotërinj, ju jep llogari RTSH-ja, sikurse edhe ne, për aspekte të ndryshme. Kështu që janë pak delikate, ligjvënësi e ka precizuar mirë që nuk duhet të shkelet.

**Flutura Aça** – Zonja Bakiu.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Armela Krasniqi** – Ne ende nuk e dimë se janë shkurtuar kanalet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, neve ende nuk ka ardhur.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zonjë, më falni, që ju kundërshtoj, por neve nuk na raporton RTSH-ja as kur merr në punë dhe as kur shkarkon. Ne nuk bëjmë drejtorinë e personelit në RTSH. E kemi të pamundur këtë, më vjen keq!

Po ju them edhe një herë, RTSH-ja, në bazë të ligjit, duhet të sjellë listën programore te ne, listën e kanaleve dhe të programeve që do të përmbajë secili kanal. Akoma RTSH-ja nuk e ka sjellë, sepse afatet ligjore e përcaktojnë për t'i sjellë deri në shtator, në mos gaboj, të këtij viti. Atëherë, do të thotë se ata janë brenda kohës normale për të sjellë të gjithë ndryshimin që duan të bëjnë brenda institucionit të tyre.

**Flutura Ačka** – Faleminderit!

Urdhëroni!

Ju lutem, mikrofonin!

**Merita Baku** – Sensibilizimin në arsimin parauniversitar dhe universitar, meqenëse e përmendet ?

**Armela Krasniqi** – Në fakt, e thashë, por ka nevojë për shterim akoma. AMA vetë nuk ndërmerr fushata, por AMA mbështet projekte të organizatave të ndryshme, të individëve, kryesisht të shoqatave, të grupeve, të departamentit të gazetarisë dhe të universiteteve të ndryshme, të cilat duan të kenë studime, botime, fushata ndërgjegjësuese në shkolla, në medien lokale, gazetarët lokalë për çështje nga më të ndryshmet. Këto fushata ne i mbështesim financiarisht, por në fund nuk kemi të drejtë të ndikojmë te gjetjet e tyre studimet që bëjnë ata, analizat që bëjnë ata, por thjesht i mbështesim, kaq na ka lënë ligji si pjesë të punës sonë.

**Flutura Ačka** – Faleminderit, zonja Krasniqi!

Edhe unë do t'i bie shkurt, sepse u ezauruan pak a shumë pyetjet që kisha menduar.

Kam vetëm një vërejtje dashamirëse, që në 10 faqet e para kam lexuar dy herë një material, pra materiali është i përsëritur. 5 faqe i kam lexuar dy herë. Ndoshta jam njeri i ndjeshëm ndaj teksteve dhe mund të më ketë rënë në sy në *close reading*, të paktën mua.

Ju përmendët seksizmin si fenomen në mediet shqiptare. Jam dakord dhe është një çështje për të cilën jam e shqetësuar. Shpesh kam ankesa nga gazetarët, të cilët më shkruajnë. Të paktën në punën time kam qenë në mbrojtje të hapur të tyre në kaq vite, ju e dini. Edhe fenomeni *MeToo* në televizionet shqiptare është i tmerrshëm, pavarësisht se ne akoma nuk mundemi të hyjmë për ta hapur këtë ferr në televizionet shqiptare. Madje, ditët e fundit doli

dhe një denoncim në një nga televizionet shqiptare dhe ajo vajzë humbi, askush nuk u mor me atë, megjithëse ishte kreu i fillit të *MeToo*-së, që mund të na ndihmonte shumë ta pastronim dhe ta shqyrtonim edhe këtë çështje në televizionet shqiptare.

Sigurisht, kjo mund të mos jetë drejtpërdrejt çështja juaj, por duke punuar me operatorë të tjerë, a mund të kthehemi në bankinë, që ta mbrojmë këtë? Sepse ka shumë nevojë dhe, në këtë pikë, të paktën në syrin tim, ka deficienca të mëdha në lidhje me mbrojtjen e gazetarëve dhe sidomos të gazetarëve.

A është në juridiksionin tuaj ndonjë lloj monitorimi për mjedisin shqiptar në televizion? Për shembull, mua më duket se mbrëmjet shqiptare janë të toksifikuara me politikë.

Çfarë raporti ka politika me medien shqiptare në televizionet shqiptare, në gazetat shqiptare, në raport me kulturën, me çështjet sociale, me mjekësinë? Cili është raporti? Mua më duket se jemi një komb shumë toksik në këtë pikë dhe jam shumë e shqetësuar. Rrallë ndodh që, në një vend kaq të vogël, se mund të jetë Amerika, që mund të ketë 100 televizione, që flasin për të njëjtën gjë dhe ka vend për të gjithë, të ketë 10 televizione, që merren çdo natë me të njëjtën gjë, me muaj të tërë. Kjo është një gjë e sëmurë dhe më duket një ambient i sëmurë për këtë komb.

Nuk e di nëse ka monitorime nga ana juaj, që të di njëfarë përqindjeje, se çfarë ndodh. Mua më duket se ka një zbalancim, por thjesht doja të dija nëse ka.

Kam komunikuar me zotin Muka për çështjen e justifikimit të gjenocidit rus. E njëjta gjë më është dukur edhe gjatë pandemisë. Ju e përmendni gjatë pandeminë dhe më vjen mirë që e përmendni, por edhe atëherë ka pasur disa figura, të cilat dilnin kundër. Dakord, ti ke lirinë tënde të dalësh, por, për mua, nuk mund të imponohesh në këtë formë në shoqëri, sepse është krim kundër njerëzimit ta bësh këtë, se kanë qenë momente shumë të vështira dhe kishin nevojë të mbroheshin fasha të caktuara...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Po, kundër vaksinimit. Ti mund ta bësh në *web*-in tënd, por nuk mund të bësh në televizionin shqiptar një gjë që bie ndesh me vullnetin e shumicës së qytetarëve! Kështu më është dukur. Ka pasur disa elemente, disa momente, të cilat nuk e di nëse i keni pasur parasysh.

Ju flisni për përmirësimin e kodit dhe më vjen mirë, jua shpjegova edhe më parë, që ne, si komision, do të merremi seriozisht me këtë.

U përmend çështja e reklamave. Kam vënë re shpesh që në kohën e fushatave zgjedhore, reklamat shtetërore mbijnë si kërpudhat para fushatës zgjedhore.

A nuk është kjo një formë e blerjes së medias, një formë e blerjes së votave? Çfarë ndodh? A e keni monitoruar këtë? Sepse, në syrin tim, ka pasur probleme të kësaj natyre. Pra,

po themi, Ministria e Mbrojtjes bën një reklamë, kur ti e di që edhe tre muaj janë zgjedhjet. Atëherë, për mua, ato para janë përdorur për diçka tjetër, se nuk ka mundësi!

A mund të vendoset në kodin tonë një nen, që 2-3 muaj para zgjedhjeve nuk është...?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atëherë, nëse është, nuk është monitoruar mirë. Unë e kam shqetësim, që mbase është me tepri i ndjeshëm, se nga kjo po vuajmë.

Kam një pyetje si qytetare dhe nuk e kam fare politike: kjo ERTV-ja çfarë lloj licence ka? Thjesht për ta ditur, jua thashë, si qytetare. Nuk më intereson fare politika. A është licencuar nga ju?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kam edhe pak dhe mbarova.

Për lirinë e medias folëm, por doja të dija, në rastin e rënies me 10 pikë të lirisë së medias, a pati ndonjë *statement* publik nga ana juaj? Ju jeni autoritet i pavarur, nuk ju intereson fare politika shtetërore.

A keni ju një qëndrim tuajin për këtë çështje, që mund të jetë dhe në kundërshtim me atë që ka dalë? Ne presim prej jush shumë në këto pika.

Çfarë qëndrimi keni ju qoftë për ta kundërshtuar, qoftë dhe për të pranuar defektet, për t'u përmirësuar? Gjithmonë, në të tilla pika, që janë çështje të mëdha publike, mendoj se autoritete të rëndësishme si ju duhet të kenë një *statement* publik.

Kam edhe një çështje të fundit, që të mos e zgjas më, e cila lidhet me gjuhën që përdoret në titra. Unë nuk e di, mund të mos jetë pjesë juaja, por është katastrofë! Unë nuk e di se si do ta zgjidhim këtë. Do ta fusim në kod? Hajde ta fusim në kod, por kjo gjë nuk mund të shtyhet më! Pra, aty lexon gjëra që janë të llahtarshme. Nuk ka redaktorë. Kanë apo nuk kanë para, redaktori është i nevojshëm. Në të gjithë botën ka redaktorë. Nuk mund të nxjerrësh të tilla titra, të cilat shkelin e fyejnë gjuhën shqipe! Çfarë do të bëjmë ne për këtë?

Këto ishin pak a shumë pyetjet që kisha. Kisha shumë pyetje, por bëra ato që m'u duken më thelbësore.

**Armela Krasniqi** – Siç ju thashë, për sa i përket seksizmit, gjendemi në kushtet ku nuk kemi asnjë akt nënligjor që e përball. Duke qenë se vërtet janë fenomene, të cilat janë sa të reja ndoshta dhe të vjetra, të titulluara ndryshe, të emërtuara ndryshe, mendojmë se në kodin e transmetimit kjo çështje do të gjejë patjetër vëmendje dhe një kapitull të veçantë. Të paktën nga institucioni ynë shihet kështu. Nuk e di se si do të jetë deri në fund dhe sa do të pranohet nga OSHMA-të, por ne do të këmbëngulim fort që të jetë një kapitull i veçantë dhe të ketë një vëmendje të shtuar në këtë pikë, pasi mendojmë se jemi deficitarë në këtë çështje.

Sa i përket mjedisit televiziv me debatet e mbrëmjes, ku japin të gjitha të njëjtën gjë, e tha pak kolegu dhe unë dua ta vijoj. Shpesh në AMA sigurisht që shumë gjëra na kërcasin dhe themi që (po e them për *relax*, se ndoshta jemi dhe drejt fundit të mbledhjes) nuk jemi dot kryeredaktorë në çdo televizion. Përderisa ka publik, përderisa ka audiencë, këto debate do të vijojnë të jenë *prime time*.

Si një njeri i medias prej 25 vjetësh, mund t'ju sjell ndoshta një eksperiencë jo shumë *relax*-uese, por disi më të mirë se jona. Kur kam filluar të militoja në radhët e gazetarëve, debatet politike në Itali ishin *prime time*. Sot është dashur një proces gati 20 vjet dhe debate politike nuk janë më *prime time*. Njerëzit kur shkojnë në shtëpi duan të çlodhen dhe kanë programe argëtuese. Nëse do ta shikosh "Vespa"-n sot, që e kam ndjekur që kur isha fëmijë, rri dhe e shikon pas orës 23:00, pasi debatet *prime time* nuk janë më në vëmendje. Pra, dua të them që OSHMA-të kanë të drejtën e vetërregullimit dhe janë ato që përcaktojnë se ku ka më shumë audiencë dhe ku nuk ka audiencë, se cila çështje është me interes publik dhe cila nuk është. Nuk mund t'i orientojmë ne OSHMA-të në këtë drejtim.

Për sa u përket skeptikëve, konspiracionistëve e termave që mund t'u vendosim njerëzve të cilët vërtet ishin agresivisht kundër vaksinimit të popullatës, mund të them që, që në momentet e para të marrjes së detyrës, në bashkëpunim me stafin, por edhe me vetë OSHMA-të, u kemi tërhequr vëmendje OSHMA-ve, pasi një nga rregullat bazë të profesionit të gazetarit është pasja minimalisht e dy burimeve. Pra, në një debat televiziv do të kesh zërin kundër, se ne nuk mund ta fenojmë zërin kundër, por duhet të kesh dhe zërin pro. Kemi operuar me OSHMA-të në vijimësi, që të gjenim një lloj balance ndërmjet këtij mendimi të skeptikëve, konspiracionistëve, kritikëve, t'i quajmë si të duam, dhe atyre të cilët janë mjekë, profesorë, shkencëtarë të fushës së mjekësisë. Kemi këmbëngulur fort jo me një, por me shumë shkresa drejtuar OSHMA-ve. Jo gjithmonë mund të them se OSHMA-të na kanë dëgjuar dhe jo gjithmonë janë treguar, le të themi, *rigid*-e në qëndrimet e tyre.

Dua të them që në kaq muaj në drejtimin e Autoritetit, kam ndier një lloj bashkëpunimi shumë pozitiv në raportin Autoritet-OSHMA, të cilat shumë shpesh reagojnë ndaj qëndrimeve të Autoritetit, ndoshta ndonjëherë edhe në mënyrë të papritur nga ana institucionale. Shumë shpesh, për të gjitha këto fenomenet e minorenëve, të seksizmit dhe të viktimave të krimit seksual apo të bulizmit, ne kemi ndërhyrë dhe u kemi kërkuar OSHMA-ve t'i heqin këto pamje edhe nga platformat e tyre sociale, t'i heqin këto pjesë të programit edhe nga rrjeti i tyre *YouTube* dhe, në fakt, OSHMA-të kanë reflektuar. Në të gjitha rastet kur ne kemi ngritur shqetësimin, OSHMA-të kanë reflektuar menjëherë dhe sigurisht që kjo, le të themi, është edhe

falë tyre, jo vetëm falë nesh; është një ndërgjegjësim nga ana e tyre në momentin kur vërtet kanë shkelur një nen të kodit të transmetimit.

Sa i takon reklamës shtetërore, në dijeninë tonë, është ligji zgjedhor që nuk lejon që, 4 muaj para fushatës zgjedhore, të ketë reklama, por ndoshta juve ju është krijuar ky perceptim pasi fushata zgjedhore nis pak më herët se 4 muaj në vendin tonë. Në fakt, në ligjin zgjedhor, për shkak të këtij shqetësimi, është e sanksionuar që 4 muaj para fushatës zgjedhore nuk duhet të nisë një reklamë shtetërore.

Me “ERTV” keni parasysh kanalën e Kryeministrit?

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Është media sociale në *Facebook*. Sa i takon medias sociale, ashtu siç nuk ka asnjë tagër ligjor sa u takon portaleve, *Facebook*-ut dhe të gjithë botës *online*, AMA nuk ka asnjë autoritet. Në fakt, ERTV-ja nuk është një kanal që mund të jetë objekt i shqyrtimit apo i monitorimit të punës së AMA-s.

Për sa i përket pyetjes: “A keni bërë një deklaratë për reporterët pa kufij?”, AMA nuk ka bërë një deklaratë të tillë, por e ka marrë të gjithë raportin dhe të gjitha departamentet (këtu janë kolegët dhe mund të dëshmojnë) kanë marrë në shqyrtim të gjitha pikat e raportit, pavarësisht se aty flitet për medien në tërësi dhe jo vetëm për televizionet në veçanti dhe radiot, që është pjesë e punës sonë. Pavarësisht kësaj, duke qenë se në Autoritet punon një pjesë e mirë e stafit me formim gazetar, ata e kanë marrë në shqyrtim të gjithë këtë raport dhe ndoshta do të jetë e domosdoshme që në vitin pasardhës të kemi mundësi të mbështesim më shumë projekte në pikat specifike që prek ky raport.

Sa i përket gjuhës shqipe, bashkëndaj plotësisht të njëjtin qëndrim me ju dhe, nëse është diçka për t’u bërë, ju lutem, ejani ta bëjmë së bashku!

**Flutura Açka** – Faleminderit, zonja Krasniqi!

A keni diçka për ta përmbyllur?

**Armela Krasniqi** – Jo, nuk kam. Për mua ishte një kënaqësi.

Ju falënderoj!

**Flutura Açka** – A kanë kolegët diçka për të shtuar?

Dakord.

Faleminderit shumë zonjës Krasniqi, zonjës Xhumbari, zonjës Plasa dhe zotit Muka, me të cilin do të komunikoj, pasi kam një çështje që sapo e kam monitoruar dhe nuk më ka pëlqyer fare, por do t’jua dërgoj, që ta shihni vetë! Nuk e di nëse ju i ndiqni gazetatat edhe në *Facebook*. Ato janë gazeta, kanë portalet e tyre në *Facebook*...

(Ndërrhyrje pa mikrofon.)



E qartë! Nuk ka ligj. Atëherë, aty abuzojnë, sepse kam parë një gjë shumë flagrante. T'i pyesësh publikisht lexuesit, shikuesit: "A është mirë që kjo filania thotë për këtë a është apo jo *gay*?". Kjo është skandaloze! Ku jemi këtu?! Është shkelje e të drejtave të njeriut të arrish në këtë pikë.

Faleminderit shumë!

**Armela Krasniqi** – Ju falënderoj shumë!

**Flutura Aça** – Mirë u takofshim sërish!

## **MBYLLET MBLEDHJA**